

RAPORT VJETOR 2018



REPUBLIKA E KOSOVËS
FOND I SIGURIMEVE SHËNDETËSORE

Përmbajtja

Lista e shkurtesave.....	1
Fjala hyrëse e Kryesuesit të Bordit Drejtues.....	2
Fjala hyrëse e Drejtorit të Fondit.....	4
Anëtarët e Bordit Drejtues.....	6
Hyrje.....	7
Aktivitetet e Bordit Drejtues.....	8
Vizioni, misioni dhe vlerat.....	9
Qëllimet strategjike dhe të arriturat gjatë vitit 2018	10
Qeverisja.....	12
1. Sistemi i kontrollit të brendshëm.....	12
1.1. Planifikimi strategjik.....	12
1.2. Legjislacioni.....	13
1.3. Komunikimi dhe raportimi.....	14
1.4. Sistemi i auditimit të brendshëm.....	15
2. Raporti i ekzekutimit të buxhetit.....	15
2.1. Burimet njerezore.....	15
2.2. Menaxhimi i financave.....	16
2.3. Menaxhimi i pasurisë.....	21
2.4. Menaxhimi i obligimeve.....	21
3. Furnizimi me barna spitalore.....	23
3.1. Ofrimi i shërbimeve shëndetësore farmaceutike.....	23
3.2. Furnizimi me barna.....	24
3.3. Shpenzimet për barna.....	25
3.4. Kontraktimi i produkteve.....	27
3.5. Sfidat.....	30
4. Ofrimi i shërbimeve shëndetësore.....	31
4.1. Kontributi në legjislacionin, planet dhe strategjitë shëndetësore.....	31
4.2. Programi i trajtimeve mjekësore jashtë ISHP-ve.....	32
4.3. Buxheti dhe shpenzimet për vitin 2018.....	33
4.4. Shpërndarja e shpenzimeve nga Programi për TMJISHP.....	35
5. Sistemet e teknologjisë informative	41
5.1. Objektivat e Departamentit të Teknologjisë Informative.....	41
5.2. Aktivitetet përgjatë vitit.....	42
6. Projekti i Shëndetësisë Kosovare.....	44
6.1. Përkrahja e definimit dhe implementimit të pakos së benefitit.....	44
6.2. Përkrahja në dizajnimin, zhvillimin dhe shfrytëzimin e SIFSSH.....	45
6.3. Zhvillimi i kapaciteteve për Fondin si blerës i shërbimeve shëndetësore.....	46
Objektivat dhe aktivitetet e planifikuara për vitin 2019.....	50
Struktura organizative.....	54

Lista e shkurtesave

FSSH	Fondi i Sigurimeve Shëndetësore
DL	Divizioni Ligjor
DFSHP	Departamenti për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme
DSISH	Departamenti i Sistemit të Informimit Shëndetësor
DSHF	Departamenti i Shërbimit Farmaceutik
DTJIPSH	Divizioni për Trajtim Jashtë Institucioneve Publike Shëndetësore
DP	Divizioni i Personelit
KASH	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve
KKUPK	Këshilli Kosovar për Udhërrëfyes dhe Protokolle Klinike
MF	Ministria e Financave
MSH	Ministria e Shëndetësisë
SHSKUK	Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës
KNS (ICD)	Klasifikimi Ndërkombëtar i Sëmundjeve
QKMF	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
IKAP	Instituti i Kosovës për Administratë Publike
GIZ	Instituti Gjerman për Bashkëpunim
BB	Banka Botërore
NJKPSHK	Njësia për Koordinimin e Projektit të Shëndetësisë Kosovare
LBE	Lista e Barnave Esenciale
SIF	Sistemi i Informimit të Fondit
IKP	Indikatorët kyç të performancës

Fjala hyrëse e Kryesuesit të Bordit Drejtues

Te nderuar,

Kam kënaqësinë të prezantoj Raportin vjetor për vitin 2018, i cili njëkohësisht është raporti i parë i Fondit të Sigurimeve Shëndetësore.

Bazuar në mandatin e dhënë me Ligjin për Sigurime shëndetësore Nr. 04/L-249, dhe me Statutin e Fondit të Sigurimeve shëndetësore, Bordi Drejtues ka mbikëqyrë veprimtarinë e Fondit, ka shqyrtuar dhe aprovuar raportet e rregullta, ka siguruar transparencën dhe ka siguruar që sistemet e kontrollit të brendshëm janë në pajtim me parimet e Menaxhimit të Financave Publike në sektorin publik.

Viti 2018 shënoi një vit kthese në rrugëtimin drejt funksionalizimit të sistemit të sigurimit shëndetësor, më qëllim të vetëm “Realizimin e të drejtave të shtetasve të Republikës së Kosovës për mbrojtjen e tyre shëndetësore”.

Fondi brenda këtij viti ka arritur të konsolidohet sa i përket organeve të tij drejtuese duke emëruar Bordin Drejtues dhe duke përzgjedhur Drejtorin e Fondit.

Gjitha parapërgatitjet për një sistem efikas të sigurimit shëndetësor janë në vazhdim e sipër me qëllim që të krijohet një themel i fortë që do të sigurojë se të gjithë qytetaret e siguruar të kenë qasje në kohë në shërbime shëndetësore.

Më gjithë të arriturat e deritanishme, fokusi ynë është të krijojmë një institucionin i cili përmes shërbimeve të ofruara, forcon ndjenjën e sigurisë tek qytetaret lidhur me potencialin e Fondit për të mbuluar shpenzimet për problemet e tyre shëndetësore.



*“Krijimi i një
institucioni kredibil i cili
me potencialin e tij
siguron qytetaret se do
të mbuloj të gjitha
shpenzimet për
problemet e tyre
shëndetësore”*

Në fund me lejon të falënderoj Ministrin e Shëndetësisë, Anëtarët e Bordit Drejtues, Drejtorin e Fondit si dhe të gjitha palët tjera të interesit të cilët kontribuan në sukseset e arritura të këtij viti në interes të realizmit të objektivave tona.

Besoj që ky raport do të ofrojë informacione të mjaftueshme për të arriturat tona gjatë vitit 2018, si dhe objektivat tona strategjike për vitet në vijim.

Prishtinë, 31 mars 2019

Naim Bardiqi



Fjala hyrëse e Drejtorit të Fondit

I nderuar Kryesues, të nderuar anëtarë të Bordit Drejtues të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore

Që nga marrja e detyrës së Drejtorit të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore, unë jam i kënaqur t'i raportoj një varg suksesesh drejtë realizimit të qëllimeve tona "funksionalizimit të Fondit".

Raporti vjetor për vitin 2018 prezanton mënyrën se si unë i kam shfrytëzuar burimet që më janë besuar, si dhe njëkohësisht mundëson krahasimin me vitet e mëparshme buxhetore dhe tregon hapat që do të ndërmerren në të ardhmen për të adresuar sfidat e hasura.

Zhvillimet në fond brenda vitit 2018, me disa pozita profesionale të rekrutuara, qoftë përmes Projektit të Shëndetësisë Kosovare si dhe atyre me Buxhetin e Kosovës, kanë ndihmuar në proces të misionit tonë drejtë funksionalizimit të Fondit, përkatësisht krijimit të një institucioni kredibil, i cili siguron qasjen universale të qytetarëve të Kosovës ndaj shërbimeve kualitative të kujdesit shëndetësor.

Përpos investimeve në stafin profesional, kemi siguruar edhe trajnime të vazhdueshme profesionale, përfshirë ato bazike dhe të avancuara. Trajnimet janë organizuar kryesisht nga stafi ndërkombëtar me përvojë të gjatë në fushën e sigurimeve shëndetësore.

Gjatë periudhës raportuese, Fondi gjithashtu ka rritur bashkëpunimin edhe me palët e interesit, ato brenda dhe jashtë vendit, për të përfituar nga përvojat e tyre drejtë krijimit të një sistemi të sa më të qëndrueshëm në mbledhjen e premieeve si dhe mbulimin e shpenzimeve shëndetësore.



"Krijimi i një institucioni kredibil i cili siguron trajtimin e barabartë të personave të siguruar dhe zgjidhjen e nevojave të tyre në kohë, me cilësi të mirë dhe kosto-efektive"

Raporti është i strukturuar në gjashtë pjesë dhe pasqyron të gjitha aktivitetet e ndërmarra nga Drejtori dhe Bordi Drejtues, evidenton qëllimet strategjike dhe të arriturat e Fondit, duke vazhduar me pjesët tjera që pasqyrojnë qeverisjen, objektivat dhe strukturën aktuale të Fondit.

Më gjithë të arriturat e deritanishme, fokusi ynë është të krijojmë një institucionin i cili përmes shërbimeve të ofruara, forcon ndjenjën e sigurisë tek qytetaret lidhur me potencialin e Fondit për të mbuluar shpenzimet për problemet e tyre shëndetësore.

Për këtë qëllim unë jam duke vazhduar të konsolidoj një ekip të fortë të Menaxherëve Ekzekutivë, me të cilët do ta hartojmë një strategji zhvillimore e cila do të shërbejë si një epokë të re në drejtim të lidershit me një qasje pro aktive për ndryshim. Në fund me lejon të falënderoj Bordin Drejtues, Stafin e Fondit si dhe të gjitha palët tjera të interesit të cilët kontribuan në sukseset e arritura të këtij viti në interes të realizmit të objektivave tona.

Prishtinë, 31 mars 2019

Fatmir Plakiqi



Drejtor i Fondit të Sigurimeve Shëndetësore

Anëtarët e Bordit Drejtues



Naim Bardiqi

Kryesues i Bordit Drejtues të FSSH-së,
Sekretar i përgjithshëm i Ministrisë së
Shëndetësisë



Xhevat Zejnullahu

Anëtar i Bordit Drejtues, përfaqësues
nga Ministria e Financave
Zëvendës Drejtor i përgjithshëm i
Thesarit, Ministria e Financave

Izedin Bytyqi

Anëtar i Bordit Drejtues, përfaqësues nga
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e
Punës dhe Mirëqenies.



Rrezart Halili

Anëtar i Bordit Drejtues, përfaqësues i
Odave të Profesionistëve Shëndetësor
Specialist i Mjekësisë Familjare – QKMF
Prishtinë (Ud.Zv.Drejtor)
Nënkryetar i Odës së Mjekëve të Kosovës



Naim Ismaili

Anëtar i Bordit Drejtues, përfaqësues
nga Agjencioni i Komunave të
Kosovës- AKK
Kryetar i Komunës së Shtimjes

Murat Berisha

Anëtar i Bordit Drejtues, përfaqësues nga
SHSKUK
Specialist, Kirurg i fëmijëve



Muhamedali Kodra

Anëtar i Bordit Drejtues, përfaqësues
nga Shoqata e Pacientëve
Anëtar i shoqatës për të drejtat e
pacientëve në Kosovë- PRAK

Hyrje

Ligji nr. 04/L-249 i Sigurimeve Shëndetësore, i aprovuar nga Kuvendi i Kosovës më 10 prill 2014, ka siguruar bazën ligjore për sigurimin shëndetësor publik në Republikën e Kosovës.

Fondi i Sigurimeve Shëndetësore (Fondi) është institucion publik me interes të posaçëm, me autonomi ligjore të personit juridik, me të drejta, obligime, përgjegjësi dhe autorizime të veçanta, për zbatim të këtij ligji. Fondi autorizohet për përcaktimin e të drejtave dhe obligimeve të të siguruarve, lidhur me sigurimin shëndetësor të obligueshëm, si dhe përcaktimin e listës së shërbimeve të kujdesit themelor shëndetësor.

Viti 2018 shënoi një vit kthese në rrugëtimin drejt funksionalizimit të sistemit të sigurimit shëndetësor, me qëllim të vetëm “Realizimin e të drejtave të shtetasve të Republikës së Kosovës për mbrojtjen e tyre shëndetësore”.

Se këndejmi, Fondi paraqet raportin e tij të parë të punës për vitin 2018. Ky raport përmbledh aktivitetet e Fondit përgjatë vitit 2018, të cilat në masë të madhe kanë qenë të orientuara drejt funksionalizimit të sigurimit shëndetësor. Raporti është i strukturuar në gjashtë pjesë dhe pasqyron të gjitha aktivitetet e ndërmarra nga Drejtori dhe Bordi Drejtues, evidenton qëllimet strategjike dhe të arriturat e Fondit, duke vazhduar me pjesët tjera që pasqyrojnë qeverisjen, objektivat dhe strukturën aktuale të Fondit.

Gjitha parapërgatitjet për një sistem efikas të sigurimit shëndetësor janë në vazhdim e sipër me qëllim që të krijohet një themel i fortë që do të sigurojë se të gjithë qytetaret e siguruar të kenë qasje në kohë në shërbime shëndetësore.

Aktivitetet e Bordit Drejtues

Bazuar në Ligjin Nr. 04/L-249 për Sigurimet Shëndetësore, Qeveria e Republikës së Kosovës, me vendimin nr. 11/42 të datës 19.04.2018 ka emëruar Bordin Drejtues të Fondit.

Bordi Drejtues i Fondit ka mbajtur takimin e parë (mbledhja konstituive) më datë 02.05.2018, në të cilin takim janë përzgjedhur Kryesuesi i Bordit Drejtues dhe sekretaria e tij.

Bazuar në kompetencat e përcaktuara me Ligjin për Sigurime shëndetësore Nr. 04/L-249, dhe me Statutin e Fondit, Bordi Drejtues kanë mbikëqyrë veprimtarinë e Fondit, ka shqyrtuar dhe aprovuar raportet e rregullta, ka siguruar transparencën dhe ka siguruar që sistemet e kontrollit të brendshëm të jenë në pajtim me parimet e Menaxhimit të Financave Publike në sektorin publik.

Gjatë vitit 2018, Bordi Drejtues kishte mbajtur gjithsej trembëdhjetë (14) takime të rregullta në të cilat janë nxjerrë vendime, konkluzione dhe rekomandime, të prezantuara në vijim:

- Procedurat e rekrutimit (konkursi, intervistimi dhe vlerësimi) dhe emërimi i Drejtorit të Fondit më datë 05.07.2018;
- Nxjerrjen e rekomandimit për Ministrin e Shëndetësisë që Fondi të ndahet si Organizatë Buxhetore e veçantë;
- Aprovimi i kriterëve për logon e Fondit si dhe vazhdimi i procedurave për përzgjedhjen e saj;
- Aprovimi i raportit gjashtë (6) mujor të punës së Fondit;
- Aprovimi i planit të aktiviteteve për periudhën tremujore (tetor – dhjetor 2018);
- Shqyrtimi dhe dhënia e kontributit në planin vjetor të Fondit për vitin 2019;
- Miratimi i Rregullores për Përgjegjësitë Disiplinore për stafin e Fondit; si dhe
- Miratimi i kodit etik.

Bordi Drejtues i Fondit mbetet i angazhuar në realizimin e plotë të detyrave dhe përgjegjësi të cilat i janë përcaktuar me Ligjin për Sigurime shëndetësore Nr. 04/L-249 dhe Statutin e Fondit të Sigurimeve shëndetësore.

Vizioni, misioni dhe vlerat



Vizioni

Krijimi i ndjenjës së sigurisë tek qytetarët lidhur me potencialin e Fondit për të mbuluar të gjitha shpenzimet për problemet e tyre shëndetësore.

Misioni

Misioni i Fondit të Sigurimeve Shëndetësore është të jetë një institucion kredibil i cili siguron qasjen universale të qytetarëve dhe banorëve të Republikës së Kosovës ndaj shërbimeve kualitative të kujdesit themelor shëndetësor, me qëllim të përmirësimit të indikatorëve shëndetësor dhe sigurimit të mbrojtjes financiare nga varfërimi për shkak të shpenzimeve të mëdha për kujdesin shëndetësor nëpërmjet themelimit dhe rregullimit të sistemit publik të sigurimit shëndetësor.



Vlerat themelore të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore

Synimet – Ne synojmë që të kemi zhvillim të vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm, duke u mbështetur në punonjës kompetentë dhe të orientuar drejt rezultateve;

Besueshmëria - Të jemi të besueshëm, të hapur dhe të afërt. Vendimmarrja është transparente dhe e vëmendshme ndaj të tjerëve; dhe

Bashkëpunimi - Ne krijojmë një atmosferë besimi brenda institucionit tonë dhe në marrëdhëniet me partnerët dhe klientët tanë.

Qëllimet strategjike dhe të arritura gjatë vitit 2018

Raporti vjetor i Fondit në mënyrë të strukturuar paraqet të gjitha aktivitetet e realizuara gjatë vitit 2018 si dhe qëllimet strategjike (objektivat dhe aktivitetet) deri në funksionalizimin e plotë të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore. Për të qenë sa më transparent kemi shpalosur detaje të mjaftueshme për të gjitha aktivitetet e realizuara kundrejt detyrave dhe përgjegjësive të deleguara.

Rezultatet e arritura mbulojnë aspektin organizativ, legjislativ, si dhe kontraktimet.

Në aspektin organizativ – Organet administrative janë funksionalizuar gjatë vitit 2018. Bordi është themeluar në muajin prill të vitit 2018, ndërsa pas tre (3) muajve, përkatësisht në muajin korrik 2018 është emëruar Drejtori i Fondit.

Kapacitetet e Fondit janë rritur gjithashtu me kuadro profesionale, duke angazhuar pesë (5) ekspert përmes Projektit të Shëndetësisë Kosovare, të cilët mbulojnë fusha të rëndësishme, përfshirë financat, legjislacionin dhe teknologjinë e informacionit. Përpos tyre pritet të rekrutohen edhe dy (2) ekspert tjerë të cilët mbulojnë fushën e komunikimit dhe të buxhetit.

Legjislacioni – Ligji i Sigurimeve Shëndetësore është në proces të plotësim/ndryshimeve, dhe pritet të aprovohet gjatë vitit 2019. Plotësim/ndryshimet shtesë janë të nevojshme për funksionimin normal të aktiviteteve të Fondit.

Në aspektin e legjislacionit sekondar është finalizuar Udhëzimi Administrativ për përcaktimin e çmimeve për barna dhe pajisje medicinale, si dhe është draftuar Udhëzimi Administrativ për përcaktimin e kriterëve për lirim nga pagesa e premie, bashkë-pagesat dhe pagesat tjera për shërbime shëndetësore. Po ashtu komisioni përgjegjës ka draftuar dhe dorëzuar listën e shërbimeve bazike me çmime testuese, si dhe janë finalizuar format e raportimit nga të gjitha institucionet shëndetësore në Fond.

Kontraktimet – aktivitetet e kontraktuara dhe ato të mbetura në proces janë si në vijim:

- Është shpallur dosja e tenderit për Sistemin e informimit të Fondit i cili do të përfshijë edhe e-recetën dhe kontrata pritet të nënshkruhet në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2019;
- Është nënshkruar kontrata me kompaninë që do të asistojë në zbatimin e skemës së barnave jashtë-spitalore;
- Është përzgjedhur kompania që do na mbështesë në “Zbatimin dhe zhvillimin e Komunikimit në Fond si dhe nivelin Parësor shëndetësor”; dhe

- Fondi pritet se shpejti të nënshkruajë aktivitetin për partnership me Fondin Publik të Gjermanisë.

Qëllimet strategjike për të ardhmen do të jenë të orientuara në:

- Qeverisje efektive, transparente dhe llogaridhënëse;
- Përgatitja e planit strategjik pesë (5) vjeçar, plan-propozimi për financimin e sektorit të shëndetësisë, planit vjetor të punës për vitin 2020;
- Identifikimi i nevojave për plotësim /ndryshimin e akteve ligjore dhe nënligjore;
- Zhvillimi dhe implementimi i Sistemeve të Informimit të Fondit;
- Bashkëpunimi më Shërbimin Spitalor Klinik Universitar të Kosovës (SHSKUK) (KPSH) dhe Institucionet tjera te kujdesit shëndetësor;
- Propozimi i Skemës së Financimit të Sektorit të Shëndetësisë;
- Menaxhimi efikas i trajtimeve mjekësore jashtë Institucioneve Publike Shëndetësore;
- Ngritja e bashkëpunimit më institucionet tjera vendore si dhe me partneret ndërkombëtar;
- Ngritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore si dhe edukimi i vazhdueshëm profesional;
- Plotësimi i parakushteve për kontraktim të shërbimeve si dhe fillimin e mbledhjes së premiumeve;
- Përgatitja dhe finalizimi i listës së barnave jashtë-spitalore (më çmime) të cilat do të paguhen nga Fondi;
- Njoftimi i publikut përmes kampanjave informuese; dhe
- Sigurimi i lokacionit/fillimi i ndërtimit të objektit të Fondit për Sigurime Shëndetësore.

Qeverisja

1. Sistemi i kontrollit të brendshëm

Fondi është në proces të krijimit të një sistemi qeverisës duke përfshirë proceset, strukturat dhe veprimet e zbatuara të cilat mundësojnë sigurimin e qëllimeve të përgjithshme - rezultatet e synuara për qytetarët.

Proceset e rishikuara në kuadër të Fondit mundësojnë kontrolle efikase për adresimin e rreziqeve dhe ofrimin e sigurisë së arsyeshme lidhur me arritjen e rezultateve në realizimin e objektivave të Fondit.

Indikatorët matës për krijimin e një sistemi të mirë qeverisës janë, planifikimi strategjik, legjislacioni, komunikimi dhe raportimi, si dhe rishikimi/auditimi i proceseve nga auditimi i brendshëm dhe i jashtëm.

1.1. Planifikimi strategjik

Në muajin nëntor të vitit 2016, Ministria e Shëndetësisë (MSH) ka hartuar Strategjinë Sektoriale të Shëndetësisë për vitet financiare 2017-2021. Në kuadër të saj janë paraparë tri (3) objektiva strategjike, si:

- Ruajtja dhe përparimi i shëndetit;
- Sigurimi i Financimit të Qëndrueshëm Shëndetësor; dhe
- Riorganizimi i Sektorit të Shëndetësisë.

Objektiva e dytë “Sigurimi i Financimit të Qëndrueshëm Shëndetësor” është objektiva strategjike e cila duhet të realizohet nga Fondi. Kjo objektive me pas është e zbërthyer në tri (3) objektiva specifike, si:

- Riorganizimi i financimit shëndetësor;
- Përfshirja e popullatës në sigurimin e detyrueshëm shëndetësor; dhe
- Ofrimi i shërbimeve shëndetësore të arritshme dhe të barabarta.

Për realizimin e objektivave strategjike, Fondi ka hartuar planin vjetor për vitin 2019 i cili mënyrë të strukturuar paraqet të gjitha objektivat dhe aktivitetet e përcaktuara drejtë funksionalizimit të plotë të Fondit, i përcaktuar me Ligjin 04L/249 për Sigurimin Shëndetësor.

Planifikimi i objektivave dhe aktiviteteve është bërë duke marrë parasysh të gjitha burimet me të cilat disponon Fondi i Sigurimeve Shëndetësore, përfshirë burimet njerëzore dhe ato financiare.

Ky plan para finalizimit është diskutuar me të gjitha palët e interesit të cilët janë të ndërlidhur apo ndihmojnë në procesin e funksionalizimit të Fondit.

Realizimi i këtij plani do të kontribuojë në realizimin e misionit të Fondit, “Sigurimi i qasjes universale të qytetarëve dhe banorëve të Republikës së Kosovës ndaj shërbimeve kualitative të kujdesit themelor shëndetësor, me qëllim të përmirësimit të indikatorëve shëndetësor dhe sigurimit të mbrojtjes financiare nga varfërimi për shkak të shpenzimeve të mëdha për kujdesin shëndetësor nëpërmjet themelimit dhe rregullimit të sistemit publik të sigurimit shëndetësor”.

1.2. Legjislacioni

Ligji Nr. 04/L-249 i Sigurimeve Shëndetësore, i aprovuar nga Kuvendi i Kosovës më 10 prill 2014, ka siguruar bazën ligjore për sigurimin shëndetësor publik në Republikën e Kosovës.

Me pas, me datë 08 dhjetor 2016, Qeveria e Kosovës ka nxjerrë Statutin e Fondit të Sigurimeve Shëndetësore i cili ka përcaktuar organizimin, të drejtat, detyrat, përgjegjësitë dhe mënyrën e kryerjes së veprimtarisë, sipas këtij ligji.

Fondi është institucion publik me interes të posaçëm, me autonomi ligjore të personit juridik, me të drejta, obligime, përgjegjësi dhe autorizime të veçanta, për zbatim të këtij ligji. Fondi autorizohet për përcaktimin e të drejtave dhe obligimeve të të siguruarve, lidhur me sigurimin shëndetësor të obligueshëm, si dhe përcaktimin e listës së shërbimeve të kujdesit themelor shëndetësor.

Divizioni ligjor në kuadër të objektivave kryesore kishte realizimin e Programit legjislativ qeveritar 2018 si dhe Planin legjislativ për akte nënligjore për vitin 2018 nga fushëveprimi i Fondit në bashkëpunim me MSH-në.

Fokusi kryesor ka qenë në mbështetjen profesionale në hartimin e legjislacionit primar dhe sekondar. Në këtë drejtim, i është dhënë prioritet projektligjit për plotësim ndryshim të Ligjit (Nr. 04/L -249) të Sigurimeve Shëndetësore ku gjatë vitit 2018 Divizioni Ligjor ka marrë pjesë në disa takime të Grupit Punues duke e ndihmuar si në aspektin administrativo-teknik, po ashtu edhe në aspektin profesional.

Divizioni Ligjor, po ashtu ka ndihmuar në përfundimin e procedurave të hartimit të Udhëzimit Administrativ për Rregullimin e Çmimeve të Produkteve dhe Pajisjeve Medicinale, si dhe ishte

në procedurë të hartimit të Udhëzimit Administrativ për Kategoritë e Liruara nga Pagesat e premiumeve dhe bashkë-pagesat tjera.

Për më tepër, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Ministrinë e Drejtësisë janë dhënë sqarimet e nevojshme për Avokaturën Shtetërore për lëndët të cilat janë në procedurë kontestimore pranë gjykatave kompetente.

Divizioni Ligjor, po ashtu ka qenë i angazhuar edhe në hartimin e një mori aktesh juridike të brendshme të Fondit, në kuadër të Planit Tremujor (TM4 2018), që bartin rëndësi domethënëse.

Si rrjedhojë, Divizioni Ligjor deri në fund të vitit 2018 ka hartuar aktet normative si në vijim:

- Kodi Etik për Fondin (miratuar nga Bordit Drejtues);
- Draft Rregullorja për Procedurë Disiplinore (miratuar nga Bordit Drejtues);
- Draft Rregullorja për Paga dhe Mëditje për të Punësuarit (në proces të finalizimit); dhe
- Draft Rregullorja për Vlerësimin e Përformancës (në proces të finalizimit).

1.3. Komunikimi dhe raportimi

Ministria e Shëndetësisë në mars të vitit 2017 ka hartuar strategjinë e komunikimit për Sigurimin Shëndetësor për vitet 2017-2021. Qëllimi i kësaj strategjie është të ndihmohen të gjitha palët lidhur me reformimin e shëndetësisë, përmes një komunikimi të integruar dhe të ndërsjellë në dhënien dhe marrjen e informacionit më kohë.

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti duhet të posedojë raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësisë, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente.

Fondi ka ndërtuar një komunikim efektiv me punonjësit, duke ofruar mundësi për secilin punonjës të shprehet hapur si në nivelin hierarkik ashtu edhe brenda departamenteve për çështjet që lidhen natyrën e punës së tyre.

Drejtori i Fondit mban takime të rregullta me udhëheqësit e departamenteve, në të cilat diskutohet dhe raportohet lidhur me aktivitetet operative të realizuara si dhe për aktivitetet e planifikuara për periudhën e ardhshme. Me pas udhëheqësit e departamenteve mbajnë takime me stafin e tyre të cilët informohen mbi çështjet kryesore lidhur me institucionin.

Me tutje, Fondi në planin e punës për vitin 2019 ka hartuar një objektivë specifike për rishikimin e strategjisë aktuale që do të kontribuon në zhvillimin e komunikimit dhe marrëdhënieve me

publikun që do të jetë në funksion të njoftimit e publikut përmes kampanjave informuese e cila pritet të sigurojë rritjen e besimit nga ana e publikut.

1.4. Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) është themeluar në fillim të muajit tetor të vitit 2018, me rekrutimin e udhëheqësit të kësaj njësie. Përgjatë kësaj periudhe të shkurtër kohore është përgatitur Statuti i njësisë, Kodi i etikës, Plani strategjik i njësisë për periudhën tri (3) vjeçare, si dhe plani vjetor i auditimit për vitin 2019.

Plani vjetor është gjithëpërfshirës me reflektim të rreziqeve të mundshme financiare dhe operative në kuadër të Fondit si dhe ofron bazë të mjaftueshme për të ofruar siguri mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.

Ky plan përfshinë fushat të cilat i ekspozohen me shumë rreziqeve si:

- Trajtimet mjekësore jashtë Institucioneve Publike Shëndetësore;
- Financat dhe Shërbimet e Përgjithshme;
- Personelin; si dhe
- Shërbimet farmaceutike.

Auditimi i jashtëm për vitin 2018 është në proces e sipër nga Zyra Kombëtare e Auditimit. Gjatë vitit 2018, Fondi ishte pjesë përbërëse e Ministrisë së Shëndetësisë, prandaj edhe deklarata mbi të hyrat dhe shpenzimet e Fondit do të jetë brenda raportit të auditimit për pasqyrat vjetore financiare të Ministrisë. Raporti pritet të përfundojë brenda periudhës deri më 30 qershor 2019.

2. Raporti i ekzekutimit të buxhetit

2.1. Burimet njerëzore

Burimet njerëzore kanë krijuar një qasje të re të menaxhimit të burimeve njerëzore. Fokusi kryesor i tyre është drejtuar në zhvillim profesional të kapaciteteve njerëzore, ku përmes ngritjes së vazhdueshme profesionale të punonjësve synojmë të forcojmë kompetencën e stafit në punën e tyre profesionale.

Gjatë vitit 2018 janë rekrutuar 12 punonjës duke arritur numri në 36 punonjës në fund të vitit 2018. Prej tyre:

- Në kuadër të Zyrës së Drejtorit të Fondit – 4 punonjës;
- Departamenti për Shërbime Shëndetësore – 5 punonjës;
- Departamenti për Shërbime Farmaceutike – 6 punonjës;
- Departamenti për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme – 15 punonjës;
- Departamenti për Menaxhimin e Sistemeve të Informacionit – 1 punonjës;
- Divizioni Ligjor – 3 punonjës;
- Divizioni i prokurimit – 1 punonjës; dhe
- Njësia e Auditimit të Brendshëm – 1 punonjës.

Përpos tyre, përmes Projektit të Shëndetësisë Kosovare (PSHK) janë të angazhuar edhe pesë (5) punonjës, të cilët mbulojnë fushën e financave, legjislacionit dhe TI-së.

Gjatë vitit 2018, për gjithë stafin e Fondit janë mbajtur trajnime bazike dhe profesionale për të siguruar ngritjen e vazhdueshme profesionale të tyre. Po ashtu, përpos mirëmbajtjes së dosjeve fizike të personelit, është vendosur edhe sistemi elektronik i dosjeve të personelit.

Me tutje, është hartuar planin vjetor i trajnimeve për vitin 2019, në bazë të të cilit janë planifikuar trajnime bazike dhe të avancuara. Qëllimi i këtyre trajnimeve është që personeli i Fondit të ruajë njohuritë rreth proceseve të punës, si dhe të avancojë njohuritë profesionale (kompetencat) përmes pjesëmarrjes në trajnime profesionale, punëtori, etj.

2.2. Menaxhimi i financave

Fondi i Sigurimeve Shëndetësore gjatë vitit 2018 ka vepruar në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë (Kodi Organizativ 206) me 3 (tri) nën programe:

- Shërbime mbështetës Administrative-Logjistike – Programi 71900;
- Trajtimi Jashtë Institucioneve Publike Shëndetësore – Programi 71600; dhe
- Stimulim Përformancës për kuadrot Profesional – Programi 78800.

2.2.1. Shpenzimet në raport me buxhetin fillestar dhe final

Me Ligjin e Buxhetit Nr. 06/L-020 për vitin 2018, buxheti fillestar i aprovuar ishte 34,225,919€, mirëpo pas ndryshimeve buxhetore, buxheti final ishte rritur për 2,450,897€, duke arritur vlerën në 36,676,816€. Prej tyre gjatë vitit 2018 ishin shpenzuar 34,359,519€, ose 94% e buxhetit final.


Fondi gjatë vitit 2018 ka krijuar një sistem të mirë të pagesave në pajtueshmëri të plotë me rregullat e Thesarit, duke filluar nga kontraktimi e deri te ekzekutimi i tyre. Secila faturë e

pranuar fillimisht protokollohet dhe më pas paguhet brenda afateve të përcaktuara ligjore. Për të gjitha faturat e pa paguara mbahet një evidencë e veçantë të cilat janë raportuar rregullisht në MSH (për secilin muaj), të cilat me pas janë konsoliduar dhe raportuar në Ministrinë e Financave.

Tabela nr.1. Buxheti në raport me shpenzimet për vitin 2018

Emërtimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	Shpenzimet 2018	Shpenzimet në %
Paga dhe rroga	158,622	216,242	216,242	100%
Mallra dhe shërbime	22,831,097	25,466,097	23,468,610	92%
Shpenzime komunale	3,200	8,231	6,959	85%
Transfere dhe subvencione	6,000,000	9,500,000	9,192,553	97%
Shpenzime kapitale	5,233,000	1,486,246	1,475,155	99%
Gjithsej	34,225,919	36,676,816	34,359,519	94%

Figura nr.1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike



Ecuria e ndryshimeve buxhetore dhe realizimi i shpenzimeve për të gjitha kategoritë ekonomike është si në vijim:

- **Paga dhe mëditje** - Buxheti fillestar i aprovuar ishte 158,622€, mirëpo në buxhetin final kjo kategori ishte rritur në 216,242€. Në fund të vitit buxheti i realizuar ishte 216,242€, ose shprehur në përqindje në shkallën 100%;
- **Mallra dhe shërbime** - Buxheti fillestar i aprovuar për këtë kategori ishte 22,831,097, mirëpo me vendime ky buxhet ishte rritë për 2,635,000€, duke rritë vlerën e buxhetit final në 25,466,097€. Buxheti final i shpenzuar ishte 23,468,610€, ose 92%;
- **Shpenzimet komunale** - Buxheti fillestar i aprovuar për këtë kategori ishte 3,200€, mirëpo buxheti final ishte rritë në 8,231€. Buxheti i realizuar në fund të vitit për këtë kategori ekonomike ishte 6.959, ose shprehur në përqindje 85%;

- **Subvencione dhe transfere** - Buxheti fillestar i aprovuar për këtë kategori ishte 6,000,000€, mirëpo buxheti final ishte rritë për 3,500,000€, duke rritë vlerën e buxhetit final në 9,500,000€. Buxheti final i shpenzuar ishte 9,192,553€, ose 97%; dhe
- **Shpenzimet kapitale**: Buxheti fillestar i aprovuar ishte në shumën prej 5,233,000€, mirëpo me buxhetin final kjo kategori ishte reduktuar për 3,746,754€ (Situacioni i fundit për ndërtimin e spitalit në Ferizaj si dhe pajisjet për spitalet) duke rënë në 1,486,246€. Buxheti në këtë kategori ishte shpenzuar në vlerë 1,475,155€, ose 99%.


2.2.2. Shpenzimet e vitit 2018 në raport me ato të vitit 2017

Tabela nr.2. Rritja e shpenzimeve të vitit 2018 në raport me ato të vitit 2017

Emërtimi	Shpenzimet 2017	Shpenzimet 2018	Diferenca	Diferenca në %
Paga dhe roga	126,793	216,242	89,449	41%
Mallra dhe shërbime	19,835,861	23,468,610	3,632,749	15%
Shpenzime komunale	194	6,959	6,765	97%
Transfere dhe subvencione	12,557,552	9,192,553	3,364,999	-37%
Shpenzime kapitale	5,180	1,475,155	1,469,975	100%
Gjithsej	32,525,580	34,359,519	1,833,939	5%

Nga tabela me lartë vërehet se shpenzimet për vitin 2018 janë rritur për 5% në raport me vitin 2017. Në kategoritë ekonomike kishte rritje të shpenzimeve më përjashtim të kategorisë transfere dhe subvencione në të cilën shpenzimet ishin me të ulëta për 37%. Megjithatë në këtë kategori obligimet ishin dyfishuar në raport me vitin paraprak. Për me shumë detaje kjo është shpalosur të kapitujt në vijim, e posaçërisht të nënkapitulli, Trajtimet mjekësore jashtë Institucioneve Publike Shëndetësore.

Figura nr.2. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike



2.2.3. Shpenzimet e pagave dhe mëditjeve 2018 në raport me vitin 2017

Tabela nr.3. Shpenzimet për paga dhe mëditje të vitit 2018 në raport me ato të vitit 2017

Shpenzimet për paga dhe mëditje në vitin 2018 ishin rritur për 89,449€, ose për 71% në krahasim me ato të vitit 2017. Në tabelën në vijim ne i kemi shpalosur shpenzimet sipas kodeve ekonomike.

Tabela nr.3. Rritja e shpenzimeve të vitit 2018 në raport me ato të vitit 2017

Kodi ekonomik	Përshkrimi	2017	2018	Rritja në %
11110	Pagat neto përmes listës së pagave	107,564	183,782	71%
11115	Pagesa për sindikatë	159	111	-30%
11500	Tatimi në të ardhurat personale	6,993	11,753	68%
11600	Kontributi pensional - punëtori	6,038	10,297	71%
11700	Kontributi pensional - punëdhënësi	6,038	10,297	71%
Gjithsej		126,793	216,242	71%

2.2.4. Mallrat dhe shërbimet, si dhe komunalitë 2018 në raport me vitin 2017

Shpenzimet për mallra dhe shërbime si dhe komunalitë në vitin 2018 janë rritur për 3,639,394€, ose për 18% në krahasim me ato të vitit 2017. Rritja e shpenzimeve kryesisht ndërlidhet me furnizimet mjekësore, ndërsa shpenzimet tjera përafërsisht mbesin në nivel të njëjtë, me përjashtim që për disa shpenzime të njëjta janë përdorur kode ekonomike të ndryshme.

Në tabelën në vijim ne i kemi shpalosur shpenzimet sipas kodeve ekonomike.

Tabela nr.4. Mallrat dhe shërbimet, si dhe komunalitë e vitit 2018 në raport me ato të vitit 2017

Kodi ekonomik	Përshkrimi	2017	2018	Rritja në %
13140 - 13143	Shp. e udhë. zyrt. jashtë vendit	38,970	18,934	-51%
13210	Rryma	-	4,838	100%
13220	Uji	-	75	100%
13250	Shpenzimet telefonike	194	21	-89%
13260	Pagesa-vendime gjyqësore	-	2,025	100%
13320	Shpenzimet e telefonisë mobile	2,617	3,960	51%
13410	Shërbimet e arsimit trajnimit	36,675	3,200	-91%
13440	Shër.e ndrysh.intel.&këshilldh	8,605		-100%
13460	Shërbime kontraktuese tjera	190,167	128,084	-33%
13470	Shërbime teknike	-	242	100%
13502	Telefona (me pak se 1000 euro)	1,437		-100%

13503	Kompjuterë me pak se 1000 euro	12,207		-100%
13509	Pajisje tjera <1000	71	505	614%
13610	Furnizime për zyrë	11,086	122	-99%
13620	Furn. ushqim &pije(jo dreka zyrtare)	-	715	100%
13630	Furnizime mjekësore	19,521,402	23,026,099	18%
13650	Furnizim me veshmbathje	1,194		-100%
13780	Karburant për vetura	887	1,263	42%
13820	Avans për udhëtime zyrtare	2,873		-100%
13950	Regjistrimi i automjeteve	905	75	-92%
13951	Sigurimi i automjeteve	-	161	100%
13952	Taksa komunale e regjis.automj	-	85	100%
14010	Miremb. riparimi i automjet.	1,081	14	-99%
14020	Mirëmbajtja e ndërtesave	-	2,986	100%
14110	Qiraja për ndërtesa	-	58,548	100%
14210	Reklamat dhe konkurset	2,103	1,902	-10%
14220	Botimet e publikimeve	1,898		-100%
14310	Dreka zyrtare	1,803	1,251	-31%
14410	Shpenzime-vendimet e gjykatave	-	24,155	100%
14420	Pagesa-neni 39.2 lmfpp	-	196,309	100%
Gjithsej		19,836,055	23,475,569	18%

2.2.5. Subvencionet dhe transferet 2018 në raport me vitin 2017

Shpenzimet për subvencione dhe transfere në vitin 2018 janë zvogëluar për 3,357,959€, ose për 27% në krahasim me ato të vitit 2017. Zvogëlimi i shpenzimeve nuk ndërlidhet me rritjen e obligimeve në këtë kategori. Për më shumë detaje kjo është e shpalosur tek kapitulli, Ofrimi i shërbimeve shëndetësore.

Tabela nr.5. Subvencionet dhe transferet e vitit 2018 në raport me ato të vitit 2017

Kodi ekonomik	Përshkrimi	2017	2018	Rritja në %
21110	SUBV.PËR ENTITETET PUBLIKE	12,557,552	9,192,553	-27%
Gjithsej		12,557,552	9,192,553	-27%

2.2.6. Shpenzimet kapitale të vitit 2018 në raport me vitin 2017

Shpenzimet kapitale në vitin 2018 ishin rritur për 1,469,975€, në krahasim me ato të vitit 2017. Në tabelën në vijim ne i kemi shpalosur shpenzimet sipas kodeve ekonomike.

Tabela nr.6. Shpenzimet kapitale të vitit 2018 në raport me ato të vitit 2017

Kodi ekonomik	Përshkrimi	2017	2018
31122	Objektet shëndetësore	-	1,475,155
31660	Pajisje speciale mjekësore	5,180	-
	Gjithsej	5,180	1,475,155

2.3. Menaxhimi pasurisë

Pasuritë jo financiare të Fondit (Pasuria kapitale dhe jo kapitale) arrin vlerën neto në 1,569,146€, nga të cilat 1,565,002€ janë blerë në vitin 2018 (pasuria kapitale në vlerë 1,475,155€ përfshinë ndërtimin e spitalit regjional në Ferizaj, ndërsa pasuria jo kapitale në vlerë 89,847€, përfshinë blerjet e inventarit dhe pajisjeve për nevojat e Fondit, të financuara nga huamarrja e BB).

Në fund të vitit është krijuar komisioni për inventarizim të pasurisë i cili pas procesit të identifikimit/numërimit fizik të pasurisë ka hartuar raportin i cili është krahasuar me raportet e pasurisë për të identifikuar dhe eliminuar diferencat.

Pas ndarjes së Fondit si organizatë buxhetore në fillim të vitit 2019, planifikohet të behet pranim-dorëzimi i pasurisë, e me pas regjistrimi i pasurisë së Fondit në evidencat e veta kontabël.

2.4. Menaxhimi i obligimeve


Fondi gjatë vitit 2018 krijuar një sistem të mirë të pagesave në pajtueshmëri të plotë me rregullat e Thesarit, duke filluar nga kontraktimi e deri te ekzekutimi i tyre. Secila faturë e pranuar fillimisht protokollohet dhe paguhet brenda afateve të përcaktuara ligjore. Për të gjitha faturat e pa paguara mbahet një evidencë e veçantë të cilat janë raportuar rregullisht në MSH (për secilin muaj), të cilat me pas i ka konsoliduar dhe raportuar në Ministrinë e Financave.

Përkundër këtij procesi të rregullt të pagesave, një shumë e konsiderueshme e obligimeve kanë mbetur të papaguara. Në fund të vitit 2018 ato ishin në vlerë 7,503,432€, ose për 3,524,155€ më të larta në krahasim me vitin 2017 (në fund të vitit 2017 obligimet e Fondit ishin 3,979,277€).

Tabela nr.7. Obligimet e mbetura me 31 dhjetor 2018

Kategoritë ekonomike	Obligimet me 31 dhjetor 2018	Obligimet në %
Mallra dhe shërbime	56,854	0.76%
Shpenzime komunale	4,355	0.06%
Subvencionet dhe transferet	7,170,229	95.56%
Investimet kapitale	271,994	3.62%
Gjithsej	7,503,432	100.00%

Figura nr.3. Obligimet e mbetura me 31 dhjetor 2018



Përpos obligimeve të cilat janë të raportuara në Ministrinë e Financave, Fondi ka edhe disa detyrime kontingjente.

Gjatë vitit 2018 ndaj Fondit ishin bërë 39 ankesa, nga të cilat gjashtë (6) janë aprovuar, tri (3) janë kthyer në rishqyrtim. Pas këtij procesi disa prej tyre kanë bërë padi nga Fondit dhe këto raste pritet të trajtohen në vitet në vijim.

Në fund të vitit 2018 ekzistonin 20 padi në vlerë totale 164,091€. të cilat janë shpalosur në tabelën në vijim.

Tabela nr.8. Detyrimet kontingjente në fund të vitit 2018

Nr.	Paditësi	i Padituri	Përshkrimi	Vlera
1	R.B.K	MSh/FSSh	Kompensimi për trajtim jashtë vendit	10,000
2	B.S.	MSh/FSSh	Kompensim për trajtim jashtë vendit	2,500
3	R.I.	MSh/FSSh	Kompensim për trajtim jashtë vendit	3,878
4	H.R.	MSh/FSSh	Kompensim për trajtim jashtë vendit	11,000
5	A.L.	MSh/FSSh	Procedurë përmbarimore	8,000
6	R.B.	MSh/FSSh	Kompensim për trajtim jashtë vendit	900
7	U.C. shpk	MSh/FSSh	Procedurë përmbarimore	36,798
8	R.H.M	MSh/FSSh	Procedurë përmbarimore	6,380
9	M.D.	MSh/FSSh	Procedurë përmbarimore	7,890
10	M.D.	MSh/FSSh	Procedurë përmbarimore	2,180
11	E.H.	MSh/FSSh	Kompensim për trajtim jashtë vendit	6,000

12	Sh.T.	MSh/FSSh	Kompensim për trajtim jashtë vendit	4,000
13	Xh.H.	MSh/FSSh	Kompensim për trajtim jashtë vendit	3,000
14	I.I.	MSh/FSSh	Kompensim për trajtim jashtë vendit	8,000
15	A.Q.	MSh/FSSh	Procedurë përmbartimore	4,800
16	B. A.	MSh/FSSh	Kompensim për trajtim jashtë vendit	8,500
17	"MT"	MSh/FSSh	Procedurë përmbartimore	36,913
18	D.M.	MSh/FSSh	Procedurë përmbartimore	2,615
19	"A. SHPK"	MSh/FSSh	Procedurë përmbartimore	139
20	"A. SHPK"	MSh/FSSh	Procedurë përmbartimore	598
Total				164,091

3. Furnizimi me barna spitalore

3.1. Ofrimi i shërbimeve shëndetësore farmaceutike

Në vitin 2018, Departamenti për Shërbime Farmaceutike (DSHF), përmes Ligjit të Sigurimeve Shëndetësore, ka paraqitur një mënyrë të re të ofrimit të shërbimeve shëndetësore farmaceutike, në sigurimin e produkteve të Listës së Barnave Esenciale konform nevojave të Institucioneve Shëndetësore.

Gjate vitit 2018 Departamenti për Shërbime Farmaceutike ka bashkëpunuar vazhdimisht me Institucionet Shëndetësore me ç' rast janë realizuar aktivitetet si në vijim:

- Njoftimi dhe edukimi i përfaqësuesve të Institucioneve shëndetësore në lidhje me procedurat e reja për furnizim, përfshirë pranimin dhe aprovimin e planifikimeve dhe planit të veprimit të ndarë në kuartale nga Institucionet Shëndetësore;
- Kontributi në krijimin e frymës bashkëpunuese me të gjitha palët e interesit (ofruesit e shërbimeve farmaceutike; furnizuesit; MSH) me qëllim të optimalizimit të rezultateve në ofrimin e shërbimeve për pacientë;
- Komunikim i vazhdueshëm dhe efikas me përgjegjësit e Institucioneve shëndetësore në aspekt të shpenzimit racional të buxhetit, furnizimit të vazhdueshëm me barna, cilësisë së shërbimeve farmaceutike, etj;
- Komunikim i vazhdueshëm me operatorë ekonomik me qëllim të realizimit të furnizimeve konform kritereve të kontraktimit;
- Pranimi dhe aprovimi i kërkesave emergjente të proceduara nga Institucionet Shëndetësore me kërkesë të Klinikave/Repartëve për artikuj për të cilët ka pasur mungesë të kontratave me Fondin, apo vonesë të madhe në liferim, paraprakisht të aprovuara nga Drejtorët Ekzekutivë të Institucioneve Shëndetësore;
- Regjistrimi i kontratave (artikujve) në Sistemin e Menaxhimit të Kontratave - Si rezultat i gjendjes kaotike të krijuar nga tejkalimet e kontratave si dhe mos funksionalizimit të SMSF-së, nga periudha TM2-2018;

- Aprovimi i kërkesave të Institucioneve Shëndetësore është realizuar përmes Sistemit të Menaxhimit të Kontratave. Fletëporositë janë aprovuar konform Planifikimit të SHSKUK-së, (me mundësi modifikimi për raste/kërkesa emergjente; dhe
- Pjesëmarrje aktive në aktivitetet e kontraktimit të produkteve të LBA-së, si pjesë e komisioneve në hapje/vlerësim të aktiviteteve përkatëse.

3.2. Furnizimet me barna



Fondi gjatë vitit 2018 ka furnizuar me barna dhe material shpenzues Institucionet Shëndetësore të nivelit dytësor dhe tretësor në vlerë prej 23,171,072¹. Gjithashtu duhet theksuar se ShSKUK është furnizuar në mënyrë të vazhdueshme edhe nga MSH, respektivisht Divizioni i Farmacisë (programet specifike) si dhe donacionet e vazhdueshme. Pjesa me e madhe e shpenzimeve në vlerë 17,644.012€, ose rreth 76%, janë bërë vetëm për Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK), ndërsa pjesa tjetër prej 5,527,060€, ose 24% janë bërë për spitalet regjionale.

Në tabelën dhe figurën në vijim mund të shohim në detaje shpenzimet e buxhetit në raport me QKUK dhe Spitalet Regjionale.

Tabela nr.9. Shpenzimet sipas qendrave spitalore

Spitalet	Shpenzimet 2018	Diferenca në %
QKUK	17,644,012	76%
Spitali Prizren	1,565,005	7%
Spitali Pejë	1,221,501	5%
Spitali Gjakovë	807,874	3%
Spitali Gjilan	794,152	3%
Spitali Mitrovicë	505,550	2%
Spitali Vushtrri	489,499	2%
Spitali Ferizaj	143,479	1%
Gjithsej	23,171,072	100%

¹ Në tabelën nr.4. Mallrat, shërbimet dhe komunalit, furnizimet mjekësore janë prezantuar në vlerë 23,026,099€, ndërsa në këtë kapitull furnizimi me barna dhe material shpenzues është prezantuar në vlerë 23,171,072€, me diferencë 144,973€. Ndryshimi ekziston pasi që spitalet mund të jenë furnizuar, mirëpo pagesat nuk janë bërë për diferencën.

Figura nr.4. Shpenzimet e QKUK në raport me spitalet regjionale**Figura nr.5. Shpenzimet sipas qendrave spitalore**

3.3. Shpenzimet për barna

Fondi ka mbuluar pjesën më të madhe të shpenzimeve spitalore, përkatësisht afro 56% në krahasim me planifikimin real të tyre. Prej tyre, barnat me 62%, materialin shpenzues me 49% dhe citostatikët më 57%.

Të dhënat e prezantuara lidhur me përqindjen e furnizimit Institucioneve Shëndetësore me produktet e Listës së Barnave Esenciale (Barna, Citostatik dhe Material Shpenzues) janë marrë nga raportet e pranuar nga ShSKUK.

Tabela nr.10. Mbulimi i shpenzimeve nga sektori publik (Fondi)

Shpenzimet	% e mbulimit nga Fondi
Barna	62%
Material Shpenzues	49%
Citostatikë	57%
Gjithsej	56%

Figura nr.6. Mbulimi i shpenzimeve nga sektori publik (Fondi)





Tabela nr.11. Mbulimi i shpenzimeve sipas qendrave spitalore

Spitalet	Shpenzimet për barna	Material shpenzues	Citostatik
QKUK	63%	52%	57%
Spitali Prizren	59%	47%	0%
Spitali Gjakovë	56%	47%	0%
Spitali Pejë	83%	73%	0%
Spitali Gjilan	58%	46%	0%
Spitali Mitrovicë	66%	39%	0%
Spitali Ferizaj	61%	49%	0%
Spitali Vushtrri	53%	41%	0%
Mesatarja	62%	49%	7%

Figura nr.7. Mbulimi i shpenzimeve sipas qendrave spitalore



3.4. Kontraktimi i produkteve

Përpilim i planit vjetor të nevojave për kontraktim të barnave dhe materialit shpenzues nga Lista e Barnave Esenciale (LBE) është bërë në bazë të analizës së nevojave/kërkesave të Institucioneve Shëndetësore, prioriteteve dhe mundësive materiale. Konform planit vjetor të nevojave për kontraktim janë bërë kërkesa për iniciimin e procedurave për tender dhe ri-tender të barnave dhe materialit shpenzues nga Lista e Barnave Esenciale, me ç'rast gjatë vitit 2018 janë kontraktuar 106 artikuj nga pjesa e barnave, 244 artikuj nga pjesa e materialit shpenzues, si dhe 20 artikuj nga pjesa e citostatikëve.

Tabela nr.12. Artikujt e kontraktuar nga Lista e barnave esenciale

Nr.	Përshkrimi	Sasia
1	Barna	106
2	Material shpenzues	244
3	Citostatikë	20
Gjithsej		370

Figura nr.8. Artikujt e kontraktuar nga Lista e barnave esenciale




Tabela nr.13. Artikujt e kontraktuar sipas grupeve farmaceutike (Barnat)

Nr.	Përshkrimi	Sasia
1	Anti-infektivët	15
2	Anestetikët	12
3	Fluidet	12
4	Kardiovaskularët	9
5	Gastrointestinale	7
6	Hormone	7
7	Analgjetikët	6
8	Psikoterapeutikët	5
9	Hemodiazilza	5
10	Imunosupresantët	4
11	Antialergjikët	3
12	Antikonvulsantët	3
13	Antianemikët	3
14	Dermatologjikët	3
15	Diuretikët	3
16	P. Oftalmologjike	3
17	P. Gjinekologjike	2
18	Antiemetikët	1
19	Kontraceptivët	1
20	T. Respirator	1
21	V. dhe Mineralet	1
Gjithsej		106

Figura nr.9. Artikujt e kontraktuar sipas grupeve farmaceutike (Barnat)





Tabela nr.14. Artikujt e kontraktuar sipas grupeve farmaceutike (Material shpenzues)

Nr.	Përshkrimi	Sasia
1	Catheters	109
2	Sutures	57
3	Miscellaneous	25
4	Hemodializa	15
5	Needles, syringes	13
6	Gauze cotton	11
7	Gloves	8
8	Radiology M.	6
Gjithsej		244

Figura nr.10. Artikujt e kontraktuar sipas grupeve farmaceutike (Materiali shpenzues)

3.5. Sfidat

Procesi i furnizimit të Institucioneve Shëndetësore me barna dhe material shpenzues është përcjellë me vështirësi dhe probleme të natyrave të ndryshme. Sfidat kryesore ishin:

- Identifikimi dhe ndërprerja e kontratave, shpenzueshmëria e të cilave ka tejkaluar limitet e kontraktuara;
- Vështirësi në sigurimin e çmimeve të tregut për produktet e listës esenciale, sidomos për produktet e materialit shpenzues;
- Zgjatja e procedurave për lidhje të kontratave të reja;
- Mungesa e kontratave për shumë artikuj për shkak të mungesës së ofertave në procedura të tenderëve dhe ri-tenderëve (kryesisht Citostatikët dhe produktet tjera të LBE, ku kërkesa për artikuj ishte e ulët); dhe
- Vonesat në liferimin e produkteve nga Operatorët Ekonomik.

Më gjithë sfidat e cekura me lartë, DSHF, Fondi ka siguruar furnizim të Institucioneve Shëndetësore me barna dhe material të domosdoshëm (qoftë përmes donacioneve për produktet e pa kontraktuara apo edhe përmes kontraktimeve emergjente).

4. Ofrimi i shërbimeve shëndetësore

4.1. Kontributi në legjislacionin, planet dhe strategjitë shëndetësore

Gjate vitit 2018 Departamenti për Shërbime Shëndetësore në kuadër të Fondit nuk ka qenë i konsoliduar edhe pse me rregulloren e brendshme të Fondit ka qenë i paraparë si Departament, Divizioni ka pas në përbërje vetëm një zyrtar me detyrat dhe përgjegjësitë në kuadër të përshkrimit të vendit të punës.

Bazuar në planin 2018 edhe përkundër faktit që kanë qenë planifikuar shumë aktivitete, përmbushja e tyre nuk është arritur për shkak të mungesës së bazës ligjore, mungesës së kapaciteteve njerëzore, etj.

Nga aktivitetet që mund të listohen dhe që janë të rëndësishme edhe për Fondin, Divizioni ka dhënë kontributin profesional në kuadër të komisioneve, grupeve punuese për hartimin e bazës ligjore, planeve dhe strategjive.

Në kuadër të “Këshillit Kosovar për Udhërrëfyes dhe Protokolle Klinike”, Departamenti/Divizioni ka dhënë kontributin në hartimin, rishikimin dhe rekomandimin për aprovim të Udhërrëfyesve Klinik, si:

- Menaxhimi i pre-eklampsisë së rëndë dhe eklampsisë;
- Parandalimi dhe menaxhimi i hemorragjisë primare postpartale;
- Skriminimi dhe trajtimi i lezioneve prekanceroze të qafës së mitrës;
- Menaxhimi i hipertensionit arterial;
- Menaxhimi i Astmës;
- Udhërrëfyesi për shërbimet e HIV testit;
- Menaxhimi jo farmakologjik i sëmundjes së sheqerit; dhe
- Transporti neonatal.

Departamenti/divizioni ka dhënë kontributin e tij edhe në kuadër të “Grupit punues për vizitat në shtëpi për nëna dhe fëmijë”.

Në kuadër të aktiviteteve tjera, Departamenti/Divizioni ka dhënë kontribut në koordinimin e aktiviteteve brenda dhe jashtë Fondit të Sigurimit Shëndetësor dhe atë: për Divizionin për Trajtim Jashtë Institucioneve Publike Shëndetësore, për Identifikimin e kodeve sipas ICD10, në listën e Dg. të pacientëve të cilët janë dërguar në trajtim jashtë institucioneve publike shëndetësore.

Në kuadër të Ligjit për Sigurime Shëndetësore, Lista e shërbimeve pa pagesë, është bërë përkthimi dhe përshtatja e dokumentit: “Pakoja Bazike e Shërbimeve Shëndetësore për Kujdesin Parësor Shëndetësor”.

Gjatë kësaj periudhe është realizuar koordinim i vazhdueshëm me Divizionin për Monitorim dhe Vlerësim të Ministrisë së Shëndetësisë në përmbushjen e obligimeve lidhur me plotësimin e formularëve si dhe raportimin lidhur e Indikatorëve të Fondit.

Gjithashtu në kuadër të vlerësimit të gjendjes shëndetësore është bërë identifikimi i indikatorëve të performancës në institucionet shëndetësore, si dhe indikatorëve të cilësisë dhe sigurisë së pacientit.

4.2. Programi i trajtimeve mjekësore jashtë ISHP-ve

Programi për trajtim mjekësor jashtë institucioneve shëndetësore publike (TMJISHP) është program i themeluar me qëllim të ofrimit të shërbimeve shëndetësore në kushtet kur institucionet shëndetësore publike nuk mund të ofrojnë shërbime të tilla. Këto shërbime kryhen goftë në spitale Institucione shëndetësore private brenda ose jashtë vendit.


Funksionimi i këtij programi është i rregulluar me udhëzim administrativ në të cilin janë të parapara procedurat e përfitimit nga ky program si dhe organet për administrimin e programit. Siç prezantohet në tabelën dhe figurën në vijim, shihet se shuma e mjeteve të shpenzuara nga ky program varion nga viti në vit por në përgjithësi shpenzimet janë rritur dukshëm krahasuar me vitet e para të funksionimit të këtij programi. Nëse krahasohet shpenzimi i buxhetit prej vitit në vit në krahasim me mesataren vërehet se në vitin 2018 shpenzimi është rritur për 174% në krahasim me mesataren për periudhën 13 vjeçare.

Tabela nr.15. Ecuria e shpenzimeve të TMJISHP për periudhën 2006 – 2018

Viti	Shpenzimet	% e rritjes vjetore	% e rritjes në raport me mesataren për periudhën 13 vjeçare
2006	447,862	100%	8%
2007	713,943	159%	14%
2008	2,710,528	380%	51%
2009	2,450,430	90%	46%
2010	2,317,500	95%	44%
2011	2,232,187	96%	42%

2012	2,965,811	133%	56%
2013	3,947,872	133%	75%
2014	8,486,405	215%	161%
2015	12,371,520	146%	234%
2016	8,265,504	67%	157%
2017	12,555,852	152%	238%
2018	9,192,553	73%	174%

Figura nr.11. Ecuria e shpenzimeve të TMJIShP për periudhën 2006 – 2018



4.3. Buxheti dhe shpenzimet për vitin 2018

Buxheti fillestar i miratuar me Ligjin e Buxhetit për programin për TMJIShP për vitin 2018 ishte 6 mil€, mirëpo me vendime të Qeverisë kjo vlerë është rritur edhe për 3.5 mil€ duke e rritur buxhetin në 9.5 mil€. Prej tyre janë shpenzuar 9.2 mil€, ose 97%.

Nëse krahasohen shpenzimet e vitit 2018 me ato të vitit 2017 shohim se ato janë me të ulëta për 3,363,299€. Ulja e shpenzimeve nuk ka rrjedhë si rezultat i uljes së trajtimeve mjekësore jashtë vendit, mirëpo si rezultat i rritjes së obligimeve për këtë kategori të shpenzimeve. Nga 3,795,481€ sa ishin obligimet në fund të vitit 2017, ato janë rritur në 7,170,229€ në fund të vitit 2018.

Buxheti i ndarë për vitin 2019 për 6 mil€ nuk mbulon as obligimet e mbetura në fund të vitit 2018. Gjatë viti 2018 në këtë program kanë aplikuar gjithsej 1432 persona prej të cilëve janë

aprovuar 1,395, ose 98% te rasteve. Prej numrit të aplikimeve në 43% ishin raste urgjente ndërsa 57% raste të rregullta.

Situata e tillë e ngarkon mjaft shume këtë program duke pas parasysh kërkesat e mëdha të pacienteve për të mbështetur mjekimin e tyre.

Tabela nr.16. Lendet e shqyrtuara dhe aprovuar për vitin 2018 në raport me vitin 2017

Përshkrimi	Viti 2017	Viti 2018	Diferenca	Diferenca në %
Aplikime	1,989	1,432	(557)	-28%
Aprovime	1,741	1,395	(346)	-20%
Raste urgjente	1,037	611	(426)	-41%
Raste të rregullta	952	821	(131)	-14%

Figura nr.12. Lendet e shqyrtuara dhe aprovuar për vitin 2018 në raport me vitin 2017





Tabela nr.17. Aplikimet për trajtime mjekësore jashtë vendit të referuara sipas klinikave

Nr.	Përshkrimi	2017	2018
1	Kardiologji	564	111
2	Oftalmologji	391	437
3	Ortopedi	248	240
4	Pediatri	241	200
5	Kardiokirurgji	66	9
6	Otorinolaringologji	46	52
7	Nefrologji	44	20
8	Onkologji	109	97
13	Neurologji	29	13

14	Urologji	22	27
15	Hematologji	20	58
16	Neurokirurgji	19	18
17	Kirurgji torakale	18	22
18	Mjekesi Nukleare	18	19
19	Neonatologji	16	23
20	Kirurgji vaskulare	13	19
21	Kirurgji	12	5
22	Radiologji	41	2
23	Te tjera	72	60
Gjithsej		1,989	1,432

Figura nr.13. Aplikimet për trajtime mjekësore jashtë vendit të referuara sipas klinikave



4.4. Shpërndarja e shpenzimeve nga Programi për TMJIShP

Siç vërehet nga tabela prej rreth 9.2 mil € të shpenzuara për mjekimin e pacientëve jashtë 61% janë mjekuar në Spitalet e Turqisë, 14% në institucionet private në Kosovë dhe 10% në Gjermani. Një pjesë e pacienteve janë trajtuar edhe në shtetet e tjera por së pjesëmarrja procentuale e tyre është relativisht me e ulët. Për me shumë detaje mund t'i referohemi tabelës në vijim.

Tabela nr.18. Trajtimet mjekësore sipas vendeve për vitin 2018

Nr.	Vendi	Rastet e trajtuara	Vlera	Mesatarja e shpenzimeve sipas rasteve	% e shpenzimit sipas vendeve
1	Turqia	267	5,573,723	20,875	60.63%

2	Kosovë	485	1,272,259	2,623	13.84%
3	Gjermania	60	934,411	15,574	10.16%
4	Shqipëria	76	500,511	6,586	5.44%
5	Maqedonia	149	451,127	3,028	4.91%
6	Italia	10	243,972	24,397	2.65%
7	Kroacia	10	66,757	6,676	0.73%
8	Amerika	3	64,673	21,558	0.70%
9	Austria	5	60,153	12,031	0.65%
10	Arabia	1	13,000	13,000	0.14%
11	Anglia	1	6,102	6,102	0.07%
12	Qekia	1	5,865	5,865	0.06%
Gjithsej		1,068	9,192,553	11,526	100%

Figura nr.14. Raporti në mes të trajtimit mjekësor brenda dhe jashtë vendit për vitin 2018





Figura nr.15. Trajtimet mjekësore sipas shteteve për vitin 2018



Në raport janë prezantuar (tabela dhe grafikone) të dhënat e shpenzuara nga Programi për TMJISHP edhe sipas institucioneve shëndetësore në shtetet përfituese nga ky program. Në vijim kemi prezantuar të dhënat detaje sipas spitaleve.

Tabela nr.19. Trajtimet mjekësore në spitalet private në Kosovë për vitin 2018

Nr.	Përshkrimi	Vlera
1	A H Kosova shpk	292,536
2	NSh qendra laser.e syrit kubati	204,598
3	Klinika gjermane e syrit shpk	193,125
4	Spitali europjan ortopedik royal medical llc	124,262
5	Akat	113,200
6	Aksoy group shpk millennium hospital	112,333
7	Eye hospital shpk	105,730
8	Internacional medicine hospital	50,260
9	Italian medical group llc	45,029
10	Sinorg pharmaceutical	43,010
11	Orthomdecia shpk	36,350
12	Ortoprotech shpk	28,728
13	Elab kosova shpk	15,395
14	Cardio center shpk	14,000
15	Kshm qdt rezonanca	8,600
16	Kavaja company shpk	4,135
17	Rezonanca ushm shpk	2,700
18	Prolab shpk	2,611
19	CT scanner atk	1,925
20	Otrila ntsh	1,750
21	As travel club	391
22	Kthime	-128,409
Gjithsej		1,272,259

Tabela nr.20. Trajtimet mjekësore në spitalet në Turqi për vitin 2018

Nr.	Përshkrimi	Vlera
1	Ozel gaziomanpasa hastanesi	2,010,000
2	Mlp saglik hiz.a.s ulus subesi	875,560
3	Eren saglik hizmetleri san.ve tic.a.s.	636,680
4	Medical park	506,880
5	Istanbul memorial saglik yatirimlari a.s.	317,130
6	Ameri.hast.sag.hizm.ve tic a.s	259,045
7	Koc university hospital	143,248
8	Okan university hospital	126,730
9	Acibadem saglik hizmetleri ve	104,991
10	Anad.eg.so.ya.va.sa.te.ik.isle	52,679
11	Medipol mega	49,862
12	Baskent university healthcare group	45,083
13	Nisantasi hastanesi	35,000
14	Medicana camlica hospitals	30,300
15	Amerik.hasta.sag.hiz.ve tic as	30,000
16	Instinye universitesi saglik uygulama ve aratrima merkezi	30,000
17	Liv hospital ankara	30,000
18	Ozel academic hospital	30,000
19	Universite istinye hastanesi	30,000
20	Kivanc medikal org.ve saglik hizmetkeri a.s.	29,500
21	Cilek agaci anaokulu	28,000
22	Moment egitim arastirma saglik hizmetleri ve ticaret a.s.	28,000
23	Medical park hospital fatih	24,500
24	Losante cocuk ve yetiskin hastanesi	17,297
25	Medistate hospital	17,000
26	Goz vakfi	16,820
27	Ems.sag.hiz.ve isl.tu.otel.a.s	12,658
28	Dunyagoz hastanesi san ve tic as	11,931
29	Duny agoz	10,170
30	Te tjera	34,660
Gjithsej		5,573,724

Tabela nr.21. Trajtimet mjekësore në spitalet në Gjermani për vitin 2018

Nr.	Përshkrimi	Vlera
1	Asklepi.klini.sankt.augus.gmbh	153,947
2	Klinikum der universitat	137,025
3	Universitätsklinik.heidelberg	56,902
4	Universitätsklinikum dusseldor	37,000
5	Ini-international neuroscience institute gmbh hannover	30,000
6	Universitäts klinikum jena	30,000
7	Universitätsklinikum wurzburg	30,000
8	University hospital frankfurt	30,000
9	Berufsgenossenschaftliche unfallklinik frankfurt am main	26,676
10	Universitätsklinikum munster	26,600
11	Ors gmbh	26,393
12	Kostenvoranschlag	25,800
13	Universitätsklinikum regensbur	21,980
14	Klinikum dortmund ggmbh	21,560
15	Klinikum frankfurt hochst	21,000
16	University medical center hamburg-eppendorf	21,000
17	Universitätsklinikum erlangen	20,895
18	Helios klinikum hildesheim	20,150
19	Universitätsklinikum koln	17,500
20	Klinikum oldenburg aor	17,475
21	Charite univesitatsmedizin berlin	17,234
22	Uniklinik koln	16,450
23	Helios klinikum munchen west	11,434
24	Klinikum rechts der isar	11,200
25	Knappschaftsklinikum saar gmbh	10,565
26	Bruderkrankenhaus st.josef paderborn	9,807
27	Mk muhlenkriskliniken	9,450
28	Universtatsklinikum freiburg	8,605
29	Hdz nrw	8,100
30	Klinikum leverkusen gmbh	8,020
31	Landes krankenhaus	7,624
32	Te tjera	44,020
Gjithsej		934,411

Tabela nr.22. Trajtimet mjekësore në spitalet në Shqipëri për vitin 2018

Nr.	Përshkrimi	Vlera
1	Univers alb	354,835
2	Hygeia hospital tirana	40,845
3	International turkish hospital -medinistanbul shpk	30,000
4	Klinika gjermane syrit	29,300
5	O.e.s distrimed sh.p.k.	17,500
6	Qendra shqiptare e syve	10,920
7	Orjeta tonuzi	9,030
8	Kalama shpk	5,281
9	Klinika e syrit internacional	2,800
Gjithsej		500,511

Tabela nr.23. Trajtimet mjekësore në spitalet në Maqedoni për vitin 2018

Nr.	Përshkrimi	Vlera
1	Acibadem sistina clinical hosp	240,902
2	Jzu univ.klin.za radioter.onk	63,166
3	Pzu european eye hospital	50,100
4	Zan mitrev	34,440
5	St.erazmo	20,352
6	Jzu univerzitetska klinika za mehatologija	13,261
7	Jzu uk za traumatolog.ort	11,500
8	Pzu sistina oftalmologija	8,850
9	Audiobm mk doo skopje	5,915
10	Re medika	1,540
11	Medica istanbul	665
12	Javna zdravstvena ustanova ocni bolesti	436
Gjithsej		451,127

Tabela nr.24. Trajtimet mjekësore në spitalet në Itali për vitin 2018

Nr.	Përshkrimi	Vlera
1	Ospedale pediatr.bambino gesu	158,000
2	Humanitas hospital	30,000
3	Burlo	24,317
4	Azienda ospedaliera univer int	18,925
5	Azienda ospedal.universi.meyer	6,500
6	Casa di cura sileno e anna rizzola spa via gorizia	6,160
7	Giovanni xxiii	70
Gjithsej		243,972

Tabela nr.25. Trajtimet mjekësore në spitalet tjera për vitin 2018

Nr.	Përshkrimi	Vlera
1	Global hearing inc	30,000
2	St.mary`s medical center	30,000
3	Klinikum wels grieskirchen gmbh	26,288
4	Klinika za dječje bolesti	22,435
5	Kepler universitätsklinikum gmbh	16,540
6	Arithera specijalna bolnica	14,000
7	Air charter international arabia ltd	13,000
8	Allgemeines krankenhaus der st	11,725
9	Kliniski bolnicki centar zagreb	10,505
10	Svjetlost klinika	7,367
11	Great ormond street hos.for children.gosh nhs fou.trust	6,102
12	Motol university hospital	5,865
13	Krankenanstalt rudolfstiftung	5,600
14	Medicinski center za stitnjacu	4,900
15	Boston children s hospital-childrens hos.inter.acc.	4,673
16	Sinteza	3,900
17	Specijalna bolnica akromion	2,950
18	Poliklinika medikol	700
Gjithsej		243,972

5. Sistemet e teknologjisë informative

5.1. Objektivat e Departamentit të Teknologjisë Informative

Departamenti i Shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit është përgjegjës për krijimin e politikave, procedurave dhe planifikimit të sistemeve të teknologjisë së informacionit (TI), për prokurimin dhe kontratat e TI-së, për sigurimin e infrastrukturës harduerike dhe softuerike dhe telekomunikimet për të gjitha sistemet të informacionit brenda Fondit. Si objektivi i departamentit ka qenë që të ofrohen shërbime gjithëpërfshirëse që lehtësojnë teknologjinë e informacionit me kosto efektive dhe zgjidhjet e telekomunikacionit që mund të funksionojnë në mënyrë të pavarur.

Për këtë arsye në muajin tetor 2018 përmes projektit të Shëndetësisë Kosovare janë angazhuar dy (2) ekspertë të jashtëm të TI-së: Specialist për Operacionet e Sistemeve të Informacionit dhe Specialist për Shërbimet e Informacionit Shëndetësor, kurse në muajin nëntor 2019 me të njëjtin projekt është angazhuar edhe eksperti në pozitën Specialist për Menaxhimin e Sistemeve të Informacionit Shëndetësor.

Ky raport pasqyron evolucionin e vazhdueshëm të misionit të TI-së dhe aktiviteteve të kryera nga departamenti për periudhën janar – dhjetor 2018, por me theks të veçantë në periudhën tetor – dhjetor 2018 kur janë angazhuar ekspertët e jashtëm.

Vizioni i Departamentit të Teknologjisë Informative:

- Teknologjia e nesërme, të shpërndahet sot.

Misioni i Departamentit të Teknologjisë Informative:

- Sigurimi i teknologjisë së besueshme të informacionit me udhëheqje dhe shërbime të telekomunikacionit që ofrojnë zgjidhje të provuara dhe me kosto efektive për të gjithë punonjësit e brendshëm, por edhe për akterët e jashtëm.

5.2. Aktivitetet përgjatë vitit

Çdo vit, DTI harton Planin e Punës për Teknologjinë e Informacionit duke përfshirë Planin e Infrastrukturës dhe Arkitekturës së sistemeve. Plani i punës përdoret për të ndihmuar në planifikimin e përpjekjeve të ardhshme të teknologjisë dhe paraqet në mënyrë të strukturuar të gjitha objektivat dhe aktivitetet e përcaktuara për fushën e TI-së.

Shërbimet e të dhënave:

- Janë krijuar procedura automatike të ruajtjes së shënimeve për kontratat e furnizimeve me barna dhe sistemi i njoftimit automatik për gjendjen e kontratave; dhe
- Janë siguruar shënimet nga Agjencia e Shoqërisë së Informacionit për sistemet që kanë qenë të ruajtura në serverët e tyre, siç kanë qenë shënimet e ueb faqes së fondit dhe aplikacionin e trajtimeve jashtë vendi.

Shërbimet e Sistemeve të Informacionit:

- Në bashkëpunim me ekspertët e Bankës Botërore është kryer rishikimi i dokumenteve të tenderit dhe janë propozuar modalitete të caktuara për Sistemin e Informimit të Fondit të Sigurimit Shëndetësor;
- Është zhvilluar Ueb aplikacioni për raportim nga njësitë e nivelit parësor, sekondar dhe tretësor i qendrave mjekësore, (Raporti i punës, Raporti i Kuadrit aktivë në kryerjen e punës dhe Raporti i shpenzimeve) për qëllime vlerësimi të shpenzimeve të procedurave në sistemin e përgjithshëm shëndetësor. Kjo do të mundësojë të kryhen veprime përgatitore, si vazhdimësi e punës në hartim të Draft çmimorës së Listës Themelore të Shërbimeve Shëndetësore, llogaritjes së koston reale të secilit shërbim. Kjo paraqet një instrument kryesor në vlerësimin e punës, në funksionalizimin e veprimtarisë së Fondit, instrument që i paraprin mundësisë së krijimit të elementeve bazë për analizë të punës së Institucioneve Shëndetësore dhe krijimit të bazës për Kontraktim në mes të Fondit dhe institucioneve shëndetësore;

- Janë identifikuar problemet e paraqitura tek aplikacioni për Trajtime Jashtë Vendi dhe së bashku me kompaninë kontraktuese është gjetur zgjidhje e përkohshme, kurse për zgjidhje afatgjatë do të punohet në pjesën e parë të vitit 2019;
- Është përgatitur dhe konfiguruar Serveri për implementimin dhe hostimin e Platformës së Sistemit të Menaxhimit të Dokumenteve. Platforma është marrë si e gatshme dhe ofrohet në opsione të ndryshme, por aktualisht është marrë versioni pa pagesë. Përmes kësaj platforme është bërë organizimi i ruajtës së dokumenteve dhe qasja e menaxhuar në këto dokumente. Kjo ka mundësuar që dokumentet e skanuara nga Zyra e Burimeve Njerëzore të ruhen sipas këtij organizimi;
- Është bërë pranimi i pajisjeve të TI-së (kompjuterë dhe telefona VOIP) të blera përmes projektit të Bankës Botërore dhe është bërë shpërndarja e tyre tek stafi i Fondit. Këto pajisje kanë ndikuar në punën ditore të stafit;
- Është hulumtuar për zgjidhje të mundshme softuerike për divizionin e Burimeve Njerëzore për të lehtësuar menaxhimin e stafit të Fondit dhe së shpejti do të zbatohet sistemi softuerik;
- Është filluar me zbatimin e Arkivit digjital ku do të ruhen lëndët në mënyrë elektronike dhe më pas do të mund të menaxhohen më lehtë dhe janë filluar të hartohen procedurat për mënyrën e qasjes në këtë arkiv;
- Është filluar hulumtimi për zbatimin e një sistemi të Tavolinës ndihmese e cila do të mundësojë evidentimin dhe menaxhimin e kërkesave apo problemeve të paraqitura nga stafi apo edhe palët e jashtme për sistemet e ndryshme; dhe
- Është bërë analiza për intranetin e Fondit, i cili do të mundësojë një qasje më të lehtë në sistemet e fondit, por edhe në dokumente të ndryshme.

Shërbimet e përgjithshme:

- Në bashkëpunim me zyrën e burimeve njerëzore gjatë muajit dhjetor është kryer procesi i rekrutimit për oficerin e TI-së;
- Është filluar procesi i verifikimit dhe nevojës për zhvillimin e procedurave që lidhen me punët dhe aktivitetet e TI-së dhe në pjesën e parë të vitit 2019 do të hartohen dokumentet e nevojshme siç janë rregulloret, politikat dhe procedurat e operimit në fushën e TI-së; dhe
- Gjatë gjithë periudhës së këtij raporti ekipi i TI-së ka dhënë mbështetjes teknike për stafin e Fondit duke ofruar zgjidhje teknike, mirëmbajtjen e pajisjeve, por edhe mirëmbajtja e rrjetit lokal.

6. Projekti i shëndetësisë Kosovare

6.1. Përkrahja e definimit dhe implementimit të pakos së benefitit

Projekti i Shëndetësisë Kosovare ka siguruar përkrahje në definimin dhe zbatimin e pakos përfituese të Sigurimeve Shëndetësore. Pakoja përfshin shërbimet e kujdesit shëndetësor që do të rimbursohen nga Fondi. Fillimisht fokusi do të jetë në barnat jashtë-spitalore të ofruara përmes barnatoreve private. Kjo nën-komponentë do të përfshijë asistencën teknike për të ndihmuar në konsultimet me grupet kyçe të interesit dhe përfituesit kryesor, si dhe përkrahje në përgatitjen e raporteve teknike, politikave dhe akteve nënligjore, si dhe në procesin e vendimmarrjes që do të ndihmoj në adoptimin e pakos. Këtu po ashtu do të përfshihet edhe përkrahja teknike për Fondin në menaxhimin e skemës së përfitimit të barnave jashtë-spitalore gjatë fazave fillestare të zbatimit.

Banka Botërore përmes projektit të Shëndetësisë Kosovare ka angazhuar pesë (5) ekspertë të cilët mbulojnë Legjislacionin, Financat dhe TI-në.

Specialisti ligjor - Specialisti ligjor është angazhuar më 01 nëntor 2018 dhe deri më 31 dhjetor 2018 ka dorëzuar të Drejtorit i Fondit këto dokumente legjislative, që mundësojnë funksionimin e Fondit por që nuk kontribuojnë direkt në aprovimin e listës së shërbimeve shëndetësore bazike. Ato janë:

- Lista e akteve nënligjore për funksionimin e plotë të Fondit;
- Draft kodin etik të personelit të Fondit; dhe
- Draft rregullorja për procedura disiplinore për stafin e Fondit.

Me tutje sipas raportit nga Projekti i Shëndetësisë konsulenti është rekomanduar të vazhdoj me kontributin e tij në plotësim/ndryshimin e akteve ligjore.

Sfidat - MSH kishte planifikuar të adresojë sfidat nëpërmjet një ndryshimi të Ligjit për Sigurimin Shëndetësor (nenet 14 dhe 15) gjatë seancës së Kuvendit (tetor-dhjetor 2018). Grupi punues ka punuar në rishikimin e Ligjit të sigurimeve shëndetësore, mirëpo deri me tani, në kohën e raportimit Ligji i rishikuar për sigurime shëndetësore ende nuk është procesuar.

6.2. Përkrahja në dizajnimin, zhvillimin dhe shfrytëzimin e SIFSSH

Projekti i Shëndetësisë Kosovare ka siguruar përkrahje në dizajnimin, zhvillimin dhe shfrytëzimin e Sistemit të Informimit të Fondit të Sigurimeve Shëndetësorë (SIFSSH), përfshirë edhe një softuerë adekuat, duke u fokusuar në modulet që janë qenësorë për zbatimin e skemës së barnave jashtë-spitalore që do të ofrohen përmes barnatoreve private (modulet do të përfshijnë data-bazën e pacienteve, regjistrin e recetave, sistemin e pagesës, funksionet menaxhuese, buxhetin, menaxhimi financiar dhe resurset njerëzore).

Specialist për Menaxhimin e Sistemeve të Informacionit Shëndetësor - Objektivi i këtij aktiviteti është ofrimi i asistencës teknike për Drejtorin e Fondit në krijimin dhe menaxhimin e Departamentit të Menaxhimit të Sistemeve të Informimit në Fond.

Në këtë drejtim konsulenti së bashku me ekipin e konsulentëve të tjerë nga fusha e TI-së:

- Është angazhuar në finalizimin e dokumenteve të tenderimit së bashku edhe me njësinë dhe Ekipin e Bankës Botërore;
- Ka mbajtur takime me departamentet përkatëse të Fondit për t'u njoftuar me procedurat standarde të operimit të departamenteve si: arkivi, trajtimi jashtë vendit, resurset humane, financat, pagesat në mënyrë që të ofron zgjidhje për automatizimin e proceseve;
- Ka siguruar përkrahje në mënyrë që të gjitha pajisjet e TI-së të jenë të instaluar, të konfiguruar dhe në funksion të plotë;
- Ka përkrahur ekipin e specialistëve në implementimin e sistemit të menaxhimit të dokumenteve në kuadër të Fondit si ruajtjes dhe arkivimit të dokumenteve, i cili është në fazën e implementimit dhe në fillim të vitit 2019 pritet të funksionalizohet në tërësi;
- Ka bashkëpunuar ngushtë me departamentin e MIS dhe me ekipin e specialistëve në analizën, dizajnimin, zhvillimin dhe implementimin e aplikacionit për qëllim të vlerësimit të kostove të procedurave në sistemin shëndetësor;
- Ka komunikuar dhe ka bashkëpunuar nga afër me Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit lidhur me rangun e IP adresave, konfigurimin dhe futjen në domen të kompjuterëve dhe pajisjeve tjera të Fondit; dhe
- Në bashkëpunim me kompaninë zbatuese, por edhe me ekipin e konsulentëve të TI-së, ka siguruar integrimin e ueb-faqes së Fondit me ueb-aplikacionin për regjistrimin e pacienteve për trajtim jashtë vendit.

Specialisti për sistemet operative të informimit shëndetësor - Ky aktivitet ka për objektiv të ofrojë asistencë teknike për Drejtorin e Fondit në përkrahje të Divizionit të Sistemit të Informimit, ku specialisti ishte përgjegjës për mirëmbajtjen, konfigurimin dhe operimin e sigurt të sistemeve kompjuterike dhe serverëve, duke siguruar funksionim të qëndrueshëm,

përformancë, resurse dhe siguri, me qëllim të përmbushjes së nevojave të shfrytëzuesve dhe funksionimin e aplikacioneve.

Gjatë periudhës tre-mujore konsulenti së bashku edhe me ekipin tjetër:

- Ka kontribuar në finalizimin e dokumentit të tenderit për sistemin e informimi të Fondit;
- Ka finalizuar furnizimin me pajisje të TI-së për Fondin, proces i filluar më herët;
- Ka implementuar pajisjet VOIP, por edhe pajisjet e tjera për shfrytëzuesit e Fondit;
- Ka monitoruar në baza ditore resurset harduerike dhe ka mirëmbajtur ato;
- Ka propozuar dhe dizajnuar strukturën e organizmit të fajlave dhe menaxhimin e dokumenteve të Fondit;
- Ka marrë pjesë në procesin e rekrutimit të zyrtarit të TI-së në Fond; dhe
- Ka instaluar dhe konfiguruar kompjuterët, por edhe ka mirëmbajtur rrjetin e brendshëm dhe atë në drejtim në institucioneve të tjera.

Specialisti për shërbimet e sistemit të informimit - Ky aktivitet kishte për objektiv të ofrojë asistencë teknike për Drejtorin e Fondit në përkrahje të Divizionit të Sistemit të Informimit, ku specialisti ishte përgjegjës për mirëmbajtjen, konfigurimin dhe operimin e sigurt të sistemeve kompjuterike dhe serverëve, duke siguruar funksionim të qëndrueshëm, përformancë, resurse dhe siguri, me qëllim të përmbushjes së nevojave të shfrytëzuesve për funksionimin e aplikacioneve.

Gjatë periudhës tre-mujore konsulenti së bashku edhe me ekipin tjetër:

- Ka kontribuar në finalizimin e dokumentit të tenderit për sistemin e informimi të Fondit;
- Ka marr pjesë në procesin e finalizimit të furnizimit me pajisje TI-së për Fondin;
- Ka bërë analizën, dizajnimin, zhvillimin dhe implementimin e aplikacionit për qëllim të vlerësimit të kostove të procedurave në sistemin shëndetësor;
- Ka identifikuar gabime të ndryshme të ueb faqen dhe ato janë adresuar tek kompania zbatuese duke ofruar edhe zgjidhjet e mundshme; dhe
- Ka filluar të analizojë proceset e punës për disa nga departamentet dhe divizionet në mënyrë që të ofrohen zgjidhje dhe të automatizohen proceset.

6.3. Zhvillimi i kapaciteteve për Fondin si blerës i shërbimeve shëndetësore

Projekti i Shëndetësisë Kosovare ka kontribuar në ndërtimin e kapaciteteve të Fondit, si blerës i shërbimeve të kujdesit shëndetësor. Këtu përfshihet asistencë teknike për Fondin në përgatitjen e buxhetit dhe dokumenteve financiare, zhvillimi i funksionit të monitorimit të financimit shëndetësor, definimi i proceseve menaxhuese që lidhen me blerjen e mallrave dhe shërbimeve shëndetësore. Përveç kësaj, kjo nën-komponentë do të mbështesë edhe krijimin e kushteve adekuata për punë (inventar dhe pajisje për zyre, trajnime, aranzhimi i binjakëzimeve dhe vizitave studimore, përkrahja teknike etj.).

Gjatë kësaj periudhe, Projekti i Shëndetësisë Kosovare ka ofruar përkrahje në përgatitjen e dokumenteve si në vijim:

- Raporti fillestar i monitorimit 6: Raporti i vlerësimit – Mentorimi i menaxhmentit të Fondit – statusi arritjeve kyçe dhe rekomandimi për aktivitet kryesorë;
- Raporti periodik i monitorimit 7: Mentorimi i menaxhmentit të Fondit – statusi arritjeve kyçe dhe rekomandimi për aktivitet kryesorë;
- Raporti periodik i monitorimit 8: Mentorimi i menaxhmentit të Fondit – konsulenti sipas Termave të Referencës dorëzon draftin final të shërbimeve shëndetësore koston e tyre sipas shpenzimeve të buxhetit të vitit 2018;
- Raporti periodik i monitorimit 9: me kërkesën e Drejtorit të Fondit ky raport paraqet vlerësimin e kapaciteteve njerëzore të Fondit si dhe rekomandimin për strategjinë e punësimit duke përfshirë profilet dhe koston për funksionalizimin e plotë të Fondit; dhe
- Konsulenti pas punës me komitetin teknik për definimin e pakos bazike të shërbimeve shëndetësore, dorëzon draftin e pakos bazike të shërbimeve shëndetësore me tavanin e koston së vlerësuar bazuar në shpenzimin e buxhetit të vitit 2018, cili mund të jetë bazë për kalibrim të mëtutjeshëm të çmimeve dhe vëllimit të shërbimeve shëndetësore pas funksionalizimit të Fondit.

Trajnimi në Sigurime Shëndetësorë dhe cilësi të shërbimeve - Në total 30 pjesëtar të stafit administrativ të Fondit u trajnuan lidhur me Sigurimet Shëndetësorë dhe Cilësinë e Shërbimeve. Gjatë kësaj periudhe me qëllim të avancimit në ndërtimin e kapaciteteve të personelit administrativ të Fondit, janë hartuar dhe mbajtur shtatë kurse trajnimi, si:

- Moduli I – “Sigurimi shëndetësor dhe cilësia e kujdesit”, u mbajt më 25 - 30 mars 2018. Në trajnim morën pjesë 26 të punësuar të Fondit dhe të akterëve të tjerë të rëndësishëm;

- Moduli II - "Financimi shëndetësor", u mbajt më 06 - 13 prill, 2018. Në trajnim morën pjesë 17 të punësuar të Fondit dhe të akterëve të tjerë të rëndësishëm;
- Moduli III - "Analiza e Kosto-efektivitetit", u mbajt më 07 - 10 maj 2018. Në trajnim morën pjesë 20 të punësuar të Fondit dhe të akterëve të tjerë të rëndësishëm; dhe
- Moduli IV - "Aplikimi "case-mix" në sistemet shëndetësore" u mbajt në periudhën 28 maj 2018 - 1 qershor 2018. Në trajnim morën pjesë 24 të punësuar të Fondit dhe të akterëve të tjerë të rëndësishëm.

Pas plotësimit të obligimeve fiskale në Kosovë, kompania konsulentë vazhdon punën me finalizimin e programit të planifikuar të Moduleve:

- Moduli V - "Menaxhimi i cilësisë së kujdesit shëndetësor" u mbajt në periudhën 15-19 shtator 2018. Në trajnim morën pjesë 29 të punësuar të Fondit dhe të akterëve të tjerë të rëndësishëm;
- Moduli VI - "Dizajnimi i paketës së përfitimit dhe shërbimeve" u mbajt në periudhën 28 maj 2018 - 1 qershor 2018. Në trajnim morën pjesë 28 të punësuar të Fondit dhe të akterëve të tjerë të rëndësishëm; dhe
- Moduli VII - "Metodat për Hulumtime shkencore në politikat shëndetësore" u mbajt në periudhën 5 – 9 nëntor 2018. Në trajnim morën pjesë 24 të punësuar të Fondit dhe të akterëve të tjerë të rëndësishëm.

Bazuar në performancën e kandidateve në të shtatë modulet disa kandidat kanë marrë certifikata për kompletimin final të moduleve dhe të tjerët për pjesëmarrje në module.

Specialisti i Menaxhimit financiar - Kjo ishte kërkesë e re nga Fondi ku përmes një Specialisti të Menaxhimit Financiar pritet të behët analiza e situatës aktuale lidhur me menaxhimit financiar në sektorin shëndetësor dhe të ofrohen këshilla mbi reformat e nevojshme në menaxhimin financiar për zbatimin e ligjit të sigurimeve shëndetësore, dhe të ofrohet përkrahje në operacionalizimin e menaxhimit financiar në Fond. Gjatë vitit 2018 janë hartuar dokumentet, si:

- Raporti i vlerësimit të stafit të menaxhimit financiar në fushën e sigurimeve shëndetësore;
- Draft plani i trajnimit për 2019".

Priten të dorëzohen në janar 2019:

- Analiza e detajuar e situatës dhe planin e veprimit për menaxhimin financiar në sektorin e shëndetësisë dhe Fond;
- Strategjia e punësimit për stafin financiar; dhe
- Propozimet për shqyrtim dhe draftim të akteve relevante nën-ligjore për Fondin dhe Menaxhimin Financiar efektiv.

Inventari dhe pajisje – Projekti i Shëndetësisë Kosovare me kërkesën e Fondit, sipas planit të prokurimit, ka siguruar inventar dhe pajisje për zyrat e reja të Fondit, si

- 20 kompjuter “Tower PC me monitorë;
- 10 laser HP printera;
- 2 printera “Canon”; dhe
- 30 telefona fiks për tavolina.

Objektivat dhe aktivitetet e planifikuara për vitin 2019

Objektiva 1.

Sigurimi i një qeverisje efektive, transparencë dhe llogaridhënia në FSSH.

Aktivitetet

- Përgatitja e një regjistri të rreziqeve të mundshme si dhe menaxhimi i efektiv i tyre;
- Menaxhimi efikas i buxhetit në përputhje me ndarjet buxhetore për vitin 2019;
- Auditimet dhe zbatimi i rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm dhe i jashtëm;
- Menaxhimi efikas dhe raportimi i drejtë dhe i saktë i obligimeve të papaguara;
- Menaxhimi efikas dhe raportimi i drejtë dhe i saktë i pasurisë jo-financiare;
- Hartimi i Pasqyrave Financiare Vjetore; dhe
- Raporti Vjetor për vitin 2018.

Objektiva 2.

Përgatitja e planit strategjik pesë (5) vjeçar dhe planit vjetor të punës për vitin 2020.

Aktivitetet

- Përgatitja e planit strategjik pesë (5) vjeçar duke përfshirë vizionin, misionin, vlerat dhe qëllimet strategjike; dhe
- Përgatitja e një regjistri të rreziqeve të mundshme si dhe menaxhimi i efektiv i tyre.

Objektiva 3.

Identifikimi i nevojave për plotësim /ndryshimin e akteve ligjore dhe nënligjore si dhe procedurave të brendshme administrative.

Aktivitetet

- Dhënia e kontributit në plotësim/ndryshim të Legjislacionit ekzistues;
- Nxjerrja e rregulloreve të reja të cilat janë të nevojshme për plotësimin e legjislacionit sekondar të Fondit për Sigurime Shëndetësore (FSSH);
- Krijimi i procedurave të brendshme administrative, përfshirë doracaket për udhëzimin e të punësuarve për punë; dhe
- Përgatitjet për marrëveshje bilaterale me shtetet tjera.

Objektiva 4.

Zhvillimi dhe implementimi i sistemeve.

Aktivitetet

- Ndërlidhja e sistemeve SISH- Sistemi i Informimit të Fondit;
- Instalimi dhe konfigurimi i pajisjeve harduerike;
- Menaxhimi, përditësimi, mirëmbajtja dhe migrimi i serverëve dhe pajisjeve të tjera; dhe
- Planifikimi, zhvillimi dhe mirëmbajtja e sistemeve të brendshme;

Objektiva 5.

Implementimi i Sistemit të Informimit të Shëndetësor.

Aktivitetet

- Kontraktimi i SIF-it;
- Implementimi i E-recetës;
- Implementimi i SIF-it (Moduli i ndërlidhjes me Agjencinë e Regjistrimit Civil (ARC), Bankën Qendrore të Kosovës (BQK), Administratën tatimore të Kosovës (ATK), si dhe institucionet tjera relevante;
- Implementimi i SIF-it (Moduli për menaxhim të financave dhe kontabilitet);
- Implementimi i SIF-it (Moduli i raportimit); dhe
- Trajnimi i shfrytëzuesve të SIF-it.

Objektiva 6.

Bashkëpunimi me Shërbimin Spitalor Klinik Universitar të Kosovës (SHSKUK) (KPSH) dhe Institucionet tjera të kujdesit shëndetësor.

Aktivitetet

- Finalizimi i procedurave për kontraktim dhe definimi modelit të kontratës për shërbime shëndetësore.

Objektiva 7.

Propozimi dhe miratimi i Plan-Propozimit të Sektorit të Shëndetësisë.

Aktivitetet

- Analiza e financimit të sektorit të shëndetësisë; dhe
- Finalizimi i Plan-Propozimit të Skemës së Financimit të Sektorit të Shëndetësisë.

Objektiva 8.

Menaxhimi efikas i trajtimeve mjekësore jashtë Institucioneve Publike Shëndetësore.

Aktivitetet

- Analiza e proceseve të trajtimit mjekësor jashtë Institucioneve Publike Shëndetësore; dhe
- Barazimi me Institucionet Shëndetësore private (Brenda dhe jashtë vendit).

Objektiva 9.

Ngritja e bashkëpunimit me Institucionet tjera vendore si dhe me partneret ndërkombëtar.

Aktivitetet

- Lidhja e marrëveshjeve të mirëkuptimit me ATK-në, ARC-në dhe me BQK-në;
- Bashkëpunimi me Odat e profesionistëve shëndetësorë;
- Lidhja e marrëveshjeve të mirëkuptimit me Institucionet e njëjta të vendeve të rajonit për shkëmbimin e përvojave;
- Partnershipi me njërin nga Fondet e vendeve anëtare të BE-së; dhe
- Bashkëpunimi me donatorët (Donacionet për ofrimin e ndihmës qoftë përmes mjeteve financiare, mbulimin e aktiviteteve ose organizimit të trajnimeve).

Objektiva 10.

Ngritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore si dhe edukimi i vazhdueshëm profesional.

Aktivitetet

- Zyrrat rajonale;
- Rekrutimi i stafit (48 pozita) për plotësimin e pozitave të lira, të nevojshme për funksionalizimin e Institucionit; dhe
- Ofrimi i trajnimeve për stafin e ri dhe stafin profesional.

Objektiva 11.

Plotësimi i parakushteve për kontraktim të shërbimeve si dhe fillimin e mbledhjes së premie sipas ligjit Nr. 04/L -249 për Sigurimin Shëndetësor.

Aktivitetet

- Krijimi i listës së shërbimeve të kujdesit shëndetësor themelor së bashku me deklaratën përkatëse financiare për vitin fiskal;
- Krijimin e listës së shërbimeve të garantuara nga neni 7 i Ligjit për Sigurime Shëndetësore;
- Krijimi i listave negative me çmime për çdo shërbim të kujdesit shëndetësor për vitin fiskal;
- Përcaktimi i bashkë-pagesave dhe niveleve tjera të bashkëfinancimit për kategoritë e liruara; dhe
- Pajisja me kartela të sigurimit, ose mjet tjetër identifikimi për të siguruarit, përfshirë se paku 75% të të punësuarve në sektorin publik dhe privat, si dhe 75% të individëve të kategorive të liruara.
-

Objektiva 12.

Përgatitja dhe finalizimi i listës së barnave jashtë-spitalore (më çmime) të cilat do të paguheshin nga FSSH.

Aktivitetet

- Inicimi i procedurës për krijimin e bazës ligjore për kontraktimin e barnatoreve;
- Finalizimi i listës së barnave jashtë-spitalore më çmime, të cilat do të paguheshin nga FSSH;
- Lidhja e marrëveshjeve të mirëkuptimit me komuna për përdorimin e E-recetës nga QKMF-të; dhe
- Lidhja e kontratave me barnatoret për barnat të cilat do të paguheshin nga FSSH.

Objektiva 13.

Njoftimi i publikut përmes kampanjave informuese dhe rritja e besimit nga ana e publikut.

Aktivitetet

- Analizë mbi nevojat e informimit, përfshirë grupet e targetuara, metodologjinë e përdorur, etj;
- Përgatitja e materialeve të nevojshme (broshurave, seminareve, spoteve, njoftimeve në faqen elektronike, etj); dhe
- Organizimi i kampanjave informuese.

Objektiva 14.


Sigurimi i lokacionit/fillimi i ndërtimit të objektit të Fondit për Sigurime Shëndetësore.

Aktivitetet

- Caktimi i parcelës, përgatitja e projektit dhe marrja e lejes së ndërtimit;
- Procedurat e tenderimit dhe lidhja e kontratës; dhe
- Fillimi i ndërtimit të objektit.

Struktura organizative

Struktura Organizative e Fondit të Sigurimit Shëndetësor përbëhet nga Zyra e Drejtorit të Fondit, katër (4) Departamenteve, si dhe katër divizioneve tjera të cilat i raportojnë direkt Drejtorit të Fondit. Në kuadër të Departamentit për Menaxhimin e Sistemeve të Informacionit janë dy divizione, Divizioni i Sistemeve të Informacionit dhe Divizioni i Shërbimeve të Informacionit.





Republika e Kosovës
Fondi i Sigurimeve Shëndetësore

Prishtinë, 2019